



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 14.06.2023)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimeve paraprake të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

1.1 “Për propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë, në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 536, datë 17.11.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

1.2 “Për propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë, në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 537, datë 17.11.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor” (dy versione).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:14 dhe mbaroi në orën 15:30.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 3. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Irena Plaku | (anëtare) |
| 6. Dritan Hallunaj | (anëtar) |

7. *Ridvan Hado* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Marçela Shehu* (anëtare)
10. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
11. *Yllka Rupa* (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani dhe Vjollca {...} Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
5. *Mary Kate Butterfield dhe Blerina Fani, përfaqësues të OPDAT-it.*
6. *Valbona Bala, eksperte (EWMI-INL).*
7. *Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimeve paraprake të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).
 - 1.1 “Për propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë, në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 536, datë 17.11.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.
 - 1.2 “Për propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë, në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 537, datë 17.11.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor” (dy versione).

Naureda Llagami: Fillojmë mbledhjen e radhës të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Siç jeni në dijeni, sot nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor do të shqyrtohen rreth 9 çështje për të cilat kërkohet vendimmarrje.

Pa humbur kohë, nëse nuk kemi diskutime mbi përmbajtjen e rendit të ditës, fillojmë me çështjen e parë e cila është një nga çështjet më të rëndësishme të Këshillit të Lartë Gjyqësor, që ka të bëjë me propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë për dy pozicione të lira në fushën e së drejtës civile. Për më shumë detaje fjalën ia jap zotit Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit znj. Kryetare!

Të nderuar kolegë, përpara mbledhjes unë po prezantoj relacionin që lidhet me projektvendimet mbi propozimin për emërimin në Gjykatën e Lartë, në pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile të shpallur me vendimet nr. 536 dhe nr. 537, datë 17.11.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, pas plotësimit të kuadrit ligjor nëpërmjet miratimit të akteve nënligjore të autorizuar nga ligji, në ushtrim të përgjegjësisë për mbarëvajtjen e sistemit dhe në veçanti të funksionit të ngritjes në detyrë të gjyqtarëve të të gjitha niveleve në kuadër të plotësimit të pozicioneve të lira në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, ndër të tjera, ka hapur procedurat e ngritjes në detyrë për dy pozicione të lira, të cilat janë në fushën e të drejtës civile, respektivisht hapur me vendimet nr. 536 dhe nr. 537 datë 17.11.2021.

Në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, brenda afateve respektive të kandidimit, kandiduan gjithsej 5 (pesë) gjyqtarë dhe konkretisht: znj. {...}; znj. {...}; znj. {...}; z. {...} dhe z. {...}.

Kandidimet për këto pozicione të lira paraqiten në formë tabelare si më poshtë:

Për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 536, datë 17.11.2021: znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, z. {...} dhe z. {...}.

Për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 537, datë 17.11.2021 renditja tabelare është si vijon më poshtë: znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, z. {...} dhe z. {...}.

Sipas pikës 9, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në një procedurë ngritjeje në detyrë për një pozicion të lirë, Këshilli i Lartë Gjyqësor bën renditjen e kandidatëve që përmbushin kriteret, renditje kjo që bëhet në funksion të përzgjedhjes së kandidatit të renditur më lart, i cili do të duhet të ngrihet në detyrë në atë pozicion të lirë ose të

propozohet për emërim në Gjykatën e Lartë.

Për të evidentuar kandidatët që përmbushnin kriteret e kandidimit, të emërimit në Gjykatën e Lartë në rastin konkret, Këshilli realizoi procedurat e verifikimit të plotësimit nga secili kandidat të kriterëve të më poshtme:

- 1) “përvojës profesionale minimale”, sipas pikës 5, të nenit 47, të Ligjit për Statusin;
- 2) “mospasjes masë disiplinore në fuqi”, sipas pikës 8, të nenit 48, të Ligjit për Statusin;
- 3) “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”, sipas nenit 8, të Ligjit për Statusin;
- 4) të pasurisë dhe figurës, sipas pikave 7 dhe 8, të nenit 48, të Ligjit për Statusin;

Me synimin për plotësimin në kohë të pozicioneve të lira të mbetura të Gjykatës së Lartë, Këshilli, si në të gjitha procedurat e ngritjes në detyrë në gjykatat më të larta ose të specializuara, ka konsideruar zhvillimin paralelisht të procedurës së verifikimit të kriterëve të kandidimit, me atë të vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve për secilin nga pozicionet e lira. Kështu, për të filluar në kohë procesin e vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve, çka do të mundësonte më pas përmbylljen e procedurës së përzgjedhjes së kandidatit të renditur më lart, Këshilli konsideroi ndarjen në dy faza të procedurës së verifikimit të kriterëve të kandidimit. Në fazën e parë të procedurës së verifikimit, kandidatët do t'i nënshtroheshin verifikimit për tre kriteret formale të kandidimit, pikërisht të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”, në logjikën sipas të cilës kandidati që nuk i plotësonte këto kriterë do të duhej të skualifikohej nga kandidimi, duke mos u bërë kështu ai pjesë e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional. Në fazën e dytë të procedurës së verifikimit, kandidatët do t'i nënshtroheshin verifikimit të kriterit të pasurisë dhe të figurës. Pas verifikimit të të gjithë kriterëve të kandidimit, Këshilli do të vendoste përfundimisht për kualifikimin ose jo të çdo kandidati.

Gjatë procedurave të verifikimit të plotësimit të kriterëve të kandidimit, për një kandidat, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur skualifikimin dhe përjashtimin nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë, në kushtet kur për atë u verifikua

mosplotësimi i kriterit të “mospasjes masë disiplinore në fuqi”.

Konkretisht, Këshilli i lartë Gjyqësor ka skualifikuar dhe përjashtuar nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë kandidatin {...}. Ai me vendimin nr. 50, datë 08.02.2022 të Këshillit është skualifikuar dhe përjashtuar nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë, në kushtet kur për të u verifikua mosplotësimi i kriterit të “mospasjes masë disiplinore në fuqi”, ndërsa ndaj kandidatit ishte dhënë masa disiplinore “shkarkim nga detyra”, me vendimin nr. 298, datë 17.09.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Ndaj këtij vendimi, kandidati paraqiti ankim pranë Gjykatës Administrative të Apelit, ndërkohë që kjo e fundit me vendimin nr. 37, datë 01.06.2022 vendosi rrëzimin e padisë.

Për 4 (katër) kandidatë të tjerë, Këshilli i Lartë Gjyqësor verifikoi plotësimin nga ata të të gjitha kriterëve të kandidimit, duke vendosur kualifikimin e tyre dhe vijimin e procedurave përkatëse për ngritjen në detyrë/emërimin në Gjykatën e Lartë. Konkretisht:

1) Znj. {...} – ka kandiduar për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës civile të shpallura përkatësisht me vendimet nr. 536 dhe nr. 537, datë 17.11.2021, si edhe për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës administrative të shpallur me vendimin nr. 535, 17.11.2021. Këshilli me vendimin nr. 130, datë 06.04.2022 vendosi kualifikimin e kandidatës dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionet në të cilat ajo ka kandiduar.

2) Znj. {...} – ka kandiduar për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës civile të shpallura përkatësisht me vendimet nr. 536 dhe nr. 537, datë 17.11.2021, si edhe për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës administrative të shpallur me vendimin nr. 535, 17.11.2021. Këshilli me vendimin nr. 129, datë 06.04.2022 ka vendosur kualifikimin e kandidatës dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë.

3) Z. {...}, ka kandiduar për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës civile të shpallura përkatësisht me vendimet nr. 536 dhe nr. 537, datë 17.11.2021, si edhe për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës administrative të shpallur me vendimin nr. 535, 17.11.2021. Këshilli me vendimin nr. 174, 05.05.2022 ka vendosur kualifikimin e kandidatit dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë.

4) Znj. {...} – e cila ka kandiduar për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës civile të shpallura përkatësisht me vendimet nr. 536 dhe nr. 537, datë 17.11.2021. Ndërsa

për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës administrative të shpallur me vendimin nr. 535, datë 17.11.2021 pasi ka aplikuar fillimisht, Këshilli me vendimin nr. 105, datë 25.03.2022 ka vendosur: “Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative të shpallur me vendimin nr. 535, datë 17.11.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi për këtë pozicion. Këshilli me vendimin nr. 175, 05.05.2022 ka vendosur kualifikimin e kandidates dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë.

Krahas procedurave të verifikimit të kriterëve të kandidimit, paralelisht, për kandidatët kanë vijuar edhe procedurat e vlerësimit etik dhe profesional, konkretisht: 1) vlerësimi me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016 (periudhën e rivlerësimit kalimtar), referuar pikës 5, të nenit 171, të Ligjit për Statusin; 2) vlerësimi i përsheptuar për vitin 2021, referuar pikës 3, të nenit 25, “Dispozitë kalimtare”, shtuar në këtë ligj me Ligjin nr. 48/2019.

Ndërsa proceset e verifikimit të kriterëve të kandidimit dhe atyre të vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve vijonin, për përfundimin në kohë të procedurave tërësore të ngritjes në detyrë, propozimit për emërim në Gjykatën e Lartë, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin nr. 193, datë 27.05.2022, filloi procedurat e përzgjedhjes së kandidatëve, ndër të tjera, edhe të atyre që kanë kandiduar për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet e tij nr. 536, dhe nr. 537, datë 17.11.2021. Me këtë vendim, si relator i procedurave të përzgjedhjes u caktua anëtari i Komisionit, z. Klodian Kurushi.

Më datë 27.05.2022, në rrugë elektronike, në zbatim të pikës 30, të Vendimit të Këshillit nr. 70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, kandidatët e kualifikuar u njoftuan për fillimin e procedurave të përzgjedhjes për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, si dhe për caktimin e relatorit. Kandidatët nuk paraqitën kundërshtime ose kërkesa për përjashtimin e relatorit apo për ndonjë nga anëtarët e tjerë të Këshillit.

Në zbatim të shkronjës “a”, pika 47, të Vendimit të Këshillit nr. 70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, relatori ka administruar dokumentacionin përkatës për secilin kandidat të kualifikuar, që gjendej në

dosjet e tyre personale apo në praktikat dokumentare të procedurave të verifikimit të plotësimit të kriterëve të kandidimit. Relatori ka administruar edhe vendimet përkatëse të Këshillit në lidhje me dy vlerësimet etike dhe profesionale për kandidatët e kualifikuar. Duhet përmendur se kandidatja, znj. {...} ka ankimuar në Gjykatën Administrative të Apelit vendimin e Këshillit nr. 537, datë 14.12.2022 për vlerësimin etik dhe profesional të saj për vitin 2021. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 19, datë 27.03.2023 ka vendosur rrëzimin e kërkesë padisë. Si i tillë, vendimi nr. 537, datë 14.12.2022 konsiderohet se ka marrë formë të prerë.

Këshilli ka përfunduar procedurën e përzgjedhjen për pozicionin e lirë në Gjykatën e Lartë në fushën e të drejtës administrative të shpallur me vendimin nr. 535, datë 14.12.2022 (*lapsus data, pasi data e vendimit 535 është 17.11.2021*), duke i propozuar Presidentit të Republikës dekretimin e znj. {...}. Në situatën si më lart, renditja e kandidatëve dhe përzgjedhja me qëllim propozimin e tyre për emërim në Gjykatën e Lartë, mund të vijojë e të përmbyllet edhe për të dy pozicionet e lira të mbetura në fushën e të drejtës civile të shpallura me vendimet e Këshillit të përmendura më lart.

Sa më sipër, relatori administroi tërësisht dokumentacionin e nevojshëm në funksion të përmbylljes së procedurës së përzgjedhjes sa i përket procedurës së ngritjes në detyrë për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile.

Për kandidaten znj. {...} u administruan dy vlerësimet etike dhe profesionale të miratuara me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 536, datë 14.12.2022 dhe nr. 537, datë 14.12.2022, vendime të cilët tashmë janë të formës së prerë.

Kandidatja, znj. {...} ka ankimuar në Gjykatën Administrative të Apelit vendimin e Këshillit nr. 537, datë 14.12.2022 për vlerësimin etik dhe profesional të vitit 2021. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 19, datë 27.03.2023 ka vendosur rrëzimin e kërkesë padisë. Si i tillë, ky vendim konsiderohet se ka marrë formë të prerë.

Ndaj vendimit nr. 536, datë 14.12.2022 nuk rezulton të jetë paraqitur ankim brenda afatit ligjor, referuar informacionit të dërguar përmes komunikimit elektronik nga Gjykata Administrative e Apelit, protokolluar pranë KLGJ-së me shkresën nr. {...} prot., datë 25.04.2023.

Për kandidaten znj. {...} u administruan dy vlerësimet etike dhe profesionale të miratuara me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 4, datë 16.01.2023 dhe nr. 161,

datë 06.04.2023, vendime të cilët janë përfundimtare, pasi ndaj tyre nuk është paraqitur ankim. Sa më sipër rezulton nga deklarata e kandidatit, përmes komunikimit elektronik të datës 18.04.2023 (lidhur me vendimin nr. 161, datë 06.04.2023), në të cilën ka shprehur dakordësinë për vendimin. Lidhur me vendimin nr. 4, datë 16.01.2023, rezulton të mos jetë paraqitur ankim referuar informacionit të dërguar përmes komunikimit elektronik nga Gjykata Administrative e Apelit dhe protokolluar pranë KLGJ-së me shkresën nr. {...} prot., datë 25.04.2023.

Për kandidatin z. {...} u administruan dy vlerësimet etike dhe profesionale të miratuara me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 456, datë 02.11.2022 dhe nr. 3, datë 16.01.2023. Këto vendime janë përfundimtare, pasi ndaj tyre nuk është paraqitur ankim referuar informacionit të dërguar përmes komunikimit elektronik nga Gjykata Administrative e Apelit, protokolluar pranë KLGJ-së me shkresën nr. {...} prot., datë 25.04.2023.

Për kandidaten znj. {...} u administruan dy vlerësimet etike dhe profesionale të miratuara me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 119, datë 15.03.2023 dhe nr. 230, datë 11.05.2023, vendime të cilët janë përfundimtare. Ndaj tyre nuk është paraqitur ankim referuar informacionit të dërguar përmes komunikimit elektronik nga Gjykata Administrative e Apelit, protokolluar pranë KLGJ-së me shkresën nr. {...} prot., datë 25.04.2023, si edhe nga komunikimi elektronik i kandidatës datë 18.05.2023.

Siç është përmendur në paragrafin 12, gjatë procedurave së përzgjedhjes, kandidatja znj. {...} ka kandiduar për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë edhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 535, datë 17.11.2021. Për këtë kandidate, në përfundim të procedurës së përzgjedhjes, Këshilli, ka miratuar renditjen e kandidatëve me vendimin nr. 212, datë 28.04.2023, ku kandidatja znj. {...} rezulton e para në renditje. Më tej, Këshilli, me vendimin nr. 270, datë 25.05.2023 ka vendosur që znj. {...} të propozohet për emërim në Gjykatën e Lartë për këtë pozicion të lirë. Nisur nga një rrethanë e tillë, duke marrë në konsideratë faktin se Këshilli i ka përfunduar procedurat për ngritje në detyrë të kësaj kandidateje për pozicionin nr. 535, datë 17.11.2021 duke e propozuar për emërim në Gjykatën e Lartë, Komisioni vlerëson se kandidimi i znj. {...} për pozicionet e tjera, duke përfshirë edhe pozicionin nr. 536, datë 17.11.2021 mbetet pa objekt.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të administruar, në përputhje me Kreun IV (Hapat, kriteret dhe përparësitë e renditjes së kandidatëve), të Vendimit 70/2020, relatori përfundoi renditjen e kandidatëve për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura nga Këshilli me vendimet e përmendura më lart.

Për renditjen e kandidatëve u mbajtën në konsideratë hapat, kriteret dhe përparësitë e renditjes së kandidatëve, sipas përcaktimeve të Vendimit nr.70/2020, mbështetur në pikën 14, të nenit 48, të Ligjit për Statusin.

Renditja e kandidatëve për pozicionin e lirë, në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 536, datë 17.11.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor:

Në procedurën e përzgjedhjes për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 536, datë 17.11.2021, u përfshinë katër kandidatë, konkretisht: znj. {...}; znj. {...}; znj. {...}; z.{...}. Për këta katër kandidatë u verifikua plotësimi i dy kërkesave të ligjit për të qenë pjesë e procedurës së përzgjedhjes për këtë pozicion të lirë: i) kualifikimi në procedurën e ngritjes në detyrë/emërimin ndërsa plotësonin kriteret e kandidimit; ii) kishin dy vlerësime etike dhe profesionale, sikurse kërkohet për efekt renditje nga shkronja “a”, pika 9, e nenit 48, të Ligjit për Statusin dhe përcaktohet në shkronjën “c”, pika 7 dhe në pikën 46, të Vendimit nr. 70/2020.

Siç u përmend edhe më sipër në këtë relacion, kandidatja znj. {...} ka kandiduar për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 535, datë 17.11.2021. Këshilli, me vendimin nr. 270, datë 25.05.2023, ka vendosur që znj. {...} të propozohet për emërim në Gjykatën e Lartë për këtë pozicion të lirë. Procedura për këtë kandidatë është përmbyllur nga Këshilli. Presidenti i Republikës, me dekretin nr. 78, datë 06.06.2023 ka emëruar zonjën {...} gjyqtare në Gjykatën e Lartë. Në këto kushte, kandidimi i znj. {...} për pozicionin nr.536 mbetet pa objekt.

Për renditjen e kandidatëve të tjerë të mbetur në garë, fillimisht u ndoq hapi i parë i renditjes, ku për secilin kandidat u bë një vlerësim krahasues i treguesve të kriterëve dhe përparësive të përcaktuara dhe të renditura në nenin 48, pika 9, shkronja “a”, të Ligjit për Statusin.

Referuar kriterit të parë të renditjes, pra atij sipas “niveleve të dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale”, për kandidatët u konstatua:

Për znj. {...} – Sipas vendimit të Këshillit nr. 536, datë 14.12.2022, kandidatja është vlerësuar/graduuar për periudhën e vlerësimit 2013-2016, në nivelin e përgjithshëm “Shkëlqyeshëm”; Sipas vendimit të Këshillit nr. 537, datë 14.12.2022, kandidatja është vlerësuar për vitin 2021, në nivelin e përgjithshëm “Shumë mirë”;

Për z. {...} – Sipas vendimit të Këshillit nr. 456, datë 02.11.2022, kandidati është vlerësuar/graduuar për periudhën e vlerësimit 2013-2016, në nivelin e përgjithshëm “Shkëlqyeshëm”; Sipas vendimit të Këshillit nr. 3, datë 16.01.2023, kandidati është vlerësuar për vitin 2021, në nivelin e përgjithshëm “Shumë mirë”.

Për znj. {...} – Sipas vendimit të Këshillit nr. 230, datë 11.05.2023, kandidatja është vlerësuar/graduuar për periudhën e vlerësimit 2013-2016, në nivelin e përgjithshëm “Shkëlqyeshëm”; Sipas vendimit të Këshillit nr. 119, datë 15.03.2023, kandidatja është vlerësuar për vitin 2021, në nivelin e përgjithshëm “Shkëlqyeshëm”.

Nga zbatimi i kriterit të parë të renditjes, pra atij sipas “niveleve të dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale”, rezultoi që një kandidate, konkretisht znj. {...}, të ketë “Shkëlqyeshëm” dy nivelet e vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale. Kurse dy kandidatët e tjerë, znj. {...} dhe z. {...} vlerësimin etik dhe profesional për periudhën e gradimit i kanë “Shkëlqyeshëm”, ndërsa vlerësimin etik dhe profesional të përshpejtuar për vitin 2021 e kanë “Shumë mirë”. Nga vlerësimi krahasues i niveleve të dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale për kandidatët, duke pasur parasysh pesë nivelet e vlerësimit sipas pikës 1, të nenit 78, të Ligjit për Statusin, identifikohet një kandidate me rezultate “Shkëlqyeshëm”, konkretisht kandidatja znj. {...}, e cila renditet më lart se kandidatët e tjerë të mbetur në garë që janë znj. {...} dhe z. {...}.

Referuar pikës 12, të Vendimit 70/2020, përcaktohet se: “12. Renditja e kandidatëve bazohet në vlerësimin krahasues të niveleve të dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale. Kandidati me nivelet më të larta të vlerësimit etik dhe profesional, renditet më lart.”

Referuar përparësisë së parë për kriterin e parë të renditjes, pra asaj sipas “nivelit të vlerësimit të fundit”, nisur nga sa më lart u parashtrua, për kandidatët u konstatua që kanë nivel të ndryshëm vlerësimi, konkretisht znj. {...} ka nivel vlerësimi “Shkëlqyeshëm”, për të dy vlerësimet etiko – profesionale, ndërsa dy kandidatët e tjerë kanë nivel “Shkëlqyeshëm”, për njërin vlerësim dhe nivel “Shumë mirë”, për vlerësimin

e përshpejtuar të vitit 2021. Për pasojë, renditja e kandidatëve mund të bëhet sipas kësaj përparësie.

Mbi këtë bazë arrihet të bëhet renditja e kandidatëve, për pozicionin e lirë, në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 536, datë 17.11.2021, ku më lart renditet kandidatja znj {...}, ndërsa kandidatët e tjerë renditen pas saj. Meqenëse pas këtij hapi arrihet të përzgjidhet kandidati që renditet i pari referuar kritereve të nivelit të vlerësimit, vijimi i hapave të tjerë të renditjes për kandidatët e tjerë është i panevojshëm.

Për pasojë, renditja e kandidatëve për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 536, datë 17.11.2021, rezulton si më poshtë:

- 1) Znj. {...};
- 2) Znj. {...} dhe z. {...};

Bazuar në sa përcaktohet në pikat 18-19, të këtij relacioni, sikundër edhe në rezultatin e renditjes sipas pikës 21 të tij, relatori përgatiti projektvendimin paraprak “Për propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë, në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 536, datë 17.11.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Sipas pikës 1 të projektvendimit paraprak, Këshillit i propozohet të miratojë renditjen e gjyqtarëve që kandidojnë për t’u emëruar në Gjykatën e Lartë, në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 536, datë 17.11.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

- 1) Znj. {...};
- 2) Znj. {...} dhe Z. {...}.

Sipas pikës 2 të projektvendimit paraprak, Këshillit i propozohet të vendosë propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë, në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 536, datë 17.11.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të kandidates znj. {...}, pra të kandidates së renditur e para për këtë pozicion.

Në pikën 3 të projektvendimit paraprak, përcaktohet se një kopje e arsyetuar e vendimit iu njoftohet kandidatëve znj. {...}, znj. {...} dhe z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Në pikën 4 të projektvendimit paraprak, përcaktohet se kundër vendimit mund të bëhet ankim nga çdo kandidat, në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.

Së fundi, në projektvendimin paraprak përcaktohet se ky vendim botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Projektvendimi paraprak “Për propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë, në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 536, datë 17.11.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, u shqyrtua paraprakisht nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës në mbledhjen e datës 02.06.2023, sikurse përcaktohet në Seksionin C, Kreu VI, të Vendimit 70/2020, ku pasi ka konstatuar si të plotë dokumentacionin e administruar për kandidatët në këtë procedurë përzgjedhjeje, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Renditja e kandidatëve për pozicionin e lirë, në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 537, datë 17.11.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor:

Kandidatja e renditur më lart, znj. {...} rezulton e renditur e para në pozicionin e lirë, në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 536, datë 17.11.2021. Për rrjedhojë, në projektvendimin paraprak për këtë pozicion të lirë, ajo propozohet për emërim në Gjykatën e Lartë. Nisur nga një rrethanë e tillë, kjo kandidate nuk mund të përzgjidhet për të vijuar procedurën edhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 537, datë 17.11.2021 sepse është përzgjedhur si kandidate e renditur e para për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 536, datë 17.11.2021.

Në vijim të procedurës, kandidatët në konkurrin për t’u propozuar për emërim në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 537, datë 17.11.2021, mbeten ata të renditur pas znj. {...}. Konkretisht, dy kandidatët e tjerë znj. {...} dhe z. {...} të cilët kanë nivel “Shkëlqyeshëm”, për njërin vlerësim dhe nivel “Shumë mirë”, për vlerësimin tjetër.

Në vijim të shkronjës “a”, të pikës 9, të nenit 48, të Ligjit për Statusin, siç u parashtrua, përcaktohet se: “... duke pasur parasysh: i) që përvoja në pozicionet e komanduara, si magjistrat në skemën e delegimit, ose si anëtar i Këshillit që i ka mbaruar mandati tre vite përpara kandidimit do të ketë përparësi; ...”. Referuar pikës 15, të

Vendimit 70/2020, është përcaktuar se: “Në rast se ka më shumë se një kandidat me rezultate të njëjta, për renditjen e kandidatëve me rezultatet më të larta zbatohen përparësitë sipas radhës së mëposhtme: a) “niveli i vlerësimit të fundit” – Sipas kësaj përparësie, kandidati me nivelin më të lartë të vlerësimit të fundit etik dhe profesional, renditet më lart; b) “përvoja si gjyqtar i komanduar, si gjyqtar në skemën e delegimit, ose si anëtar i Këshillit” – Sipas kësaj përparësie, kandidati që ka një nga këto përvoja, renditet më lart; c) “kohëzgjatja e përvojës si gjyqtar i komanduar, si gjyqtar në skemën e delegimit, ose si anëtar i Këshillit” – Sipas kësaj përparësie, kandidati me përvojën me kohëzgjatjen më të madhe në vite, renditet më lart; ç) “shumëllojshmëria e përvojave si gjyqtar i komanduar, si gjyqtar në skemën e delegimit ose si anëtar i Këshillit” – Sipas kësaj përparësie, kandidati që ka më shumë nga këto përvoja, renditet më lart”.

Referuar përparësisë së parë për kriterin e parë të renditjes, pra asaj sipas “nivelit të vlerësimit të fundit”, nisur nga sa më lart u parashtrua, për dy kandidatët u konstatua që kanë të njëjtin nivel vlerësimi, “Shumë mirë”, për vlerësimin e fundit etik dhe profesional, pra atë të vitit 2021. Për pasojë, rezultoi e pamundur renditja e kandidatëve sipas kësaj përparësie.

Referuar përparësisë së dytë për kriterin e parë të renditjes, pra asaj sipas “përvojës si gjyqtar i komanduar, si gjyqtar në skemën e delegimit, ose si anëtar i Këshillit”, relatori i parashtron Këshillit situatën e konstatuar për njërin nga kandidatët gjatë procedurës së përzgjedhjes. Konkretisht, u konstatua se njëri nga dy kandidatët me rezultate, nivele të njëjta vlerësimi etik dhe profesional, z. {...} ka përvojë/kontribut të veçantë e cila do të diskutohet nëse do të konsiderohet përparësi apo vlerë e shtuar në këtë mbledhje, duke dhënë edhe ne si Komision paraprakisht mendimin tonë.

Konkretisht z. {...} në periudhën dhjetor 2012 deri në dhjetor 2016 rezultoi të ketë pasur funksionin e anëtarit të Kolegjit Zgjedhor. Në datën 07.12.2012 z. {...} është përzgjedhur nëpërmjet shortit të zhvilluar sipas nenit 146 dhe nenit 147 të Kodit Zgjedhor në fuqi në atë kohë. Konstituimi i Kolegjit Zgjedhor duke përfshirë edhe z. {...} është bërë përpara Presidentit të Republikës nëpërmjet betimit të kryer në datë 27 dhjetor 2012.

Bazuar në nenin 147 dhe nenin 150 të Kodit Zgjedhor në fuqi në kohën e shortimit, rezultoi se z. {...} është deleguar (term i përdorur nga ligji në Kodin Zgjedhor) për të shërbyer si anëtar i Kolegjit Zgjedhor. Cilësinë si anëtar i Kolegjit Zgjedhor z. {...}

e ka marrë pas betimit të bërë konform nenit 147/2 të Kodit Zgjedhor në fuqi në atë kohë. Delegimi në këtë rast është një funksion ligjor i anëtarit të Kolegjit Zgjedhor, i përcaktuar si i tillë në nenin 150 të Kodit Zgjedhor. Pra për shkak të përcaktimit ligjor të përmendur më lart (nenet 147 dhe 150 të Kodit Zgjedhor), z. {...} ka qenë i deleguar si anëtar i Kolegjit Zgjedhor, nëpërmjet procesit të shortimit të organizuar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe betimit para Presidentit të Republikës.

Çështja që shtrohet për diskutim përpara Këshillit lidhet me nocionin nëse delegimi ligjor i z. {...} si anëtar i Kolegjit Zgjedhor në një proces kandidimi për ngritje në detyrë do të përfshihet në rastet e përvojës si vlerë e shtuar, apo jo.

Kodi Zgjedhor në nenin 149/3 ka njohur si vlerë të shtuar delegimin e gjyqtarit në Kolegjin Zgjedhor (pra e njeh si vlerë të shtuar neni 149/3). Në këtë dispozitë parashikohet se: “3. Pas përfundimit të delegimit në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, ushtrimi i detyrës në këtë Kolegj konsiderohet vlerë e shtuar në përvojë për qëllime të ngritjes në detyrë.” Ky parashikim është shtuar me ligjin 101/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili ka hyrë në fuqi më gusht 2020. Pra ndryshimet mbi vlerën e shtuar të qenies ose të delegimit si anëtar i Kolegjit Zgjedhor janë bërë me ndryshimet që ka pësuar Kodi Zgjedhor me ligjin 101/2020 që ka hyrë në fuqi në gusht të vitit 2020.

Çështja që shtrohet për diskutim është fakti nëse përparësia e parashikuar nga ligji “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, me ndryshime të cilat kanë hyrë në fuqi në gusht 2020 (botuar në fletoren zyrtare më datë 04.08.2020) do të njihet si vlerë për gjyqtarët të cilët kanë shërbyer në Kolegjin Zgjedhor përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, siç është rasti i z. {...}?

Siç u parashtrua edhe më sipër z. {...}t kjo detyrë i është caktuar për shkak të ligjit. Legjislatori është i qartë në përdorimin e nocionit delegim për anëtarët e Kolegjit Zgjedhor. Nocioni i delegimit të gjyqtarit si anëtar i Kolegjit Zgjedhor, nuk ka ndryshuar nga hyrja në fuqi e Kodit Zgjedhor në vitin 2008. Kjo detyrë buron nga ligji. Megjithëse Kodi Zgjedhor ka pësuar ndryshime, mekanizmi i përzgjedhjes nëpërmjet shortit nga KLD, fillimi i detyrës pas betimit, si edhe detyra që kryen anëtari i Kolegjit Zgjedhor nuk ka pësuar ndryshime të mëtejshme ligjore.

Pas hyrjes në fuqi të këtyre ndryshimeve ligjore nuk ka diskutime lidhur me

vlerën e shtuar të kësaj detyre si përparësi, pra flas nga viti 2020 e më tej, nuk besoj se do të kemi diskutime nëse do të njihet apo jo si vlerë përparësie sepse këtë e ka thënë ligji.

Nëse nuk do të konsiderohet përparësi/vlerë e shtuar delegimi që ka pasur z. {...} për shkak të ligjit, atëherë duhet të pranojmë faktin e diferencës në trajtim që mund të ekzistojë midis një anëtari të Kolegjit Zgjedhor që i përfundon delegimi pas ndryshimeve që ka pësuar Kodi Zgjedhor me ligjin nr.101/2020, me anëtarët e Kolegjit Zgjedhor të deleguar, që kanë ushtruar të njëjtin funksion deri përpara hyrjes në fuqi të këtyre ndryshimeve.

Në vijim të argumentit për trajtimin e çështjes është fakti se z. {...} ka shërbyer si anëtar i Kolegjit Zgjedhor përgjatë periudhës që ka hyrë në fuqi edhe Ligji për Statusin. Ligji 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” ka hyrë në fuqi në nëntor të vitit 2016 dhe z. {...} e ka ushtruar detyrën si gjyqtar i Kolegjit Zgjedhor deri më 10 dhjetor 2016. Kandidati, z. {...} nuk është përfshirë në skemën e delegimit, por ai ka qenë i deleguar për shkak të ligjit si anëtar i Kolegjit Zgjedhor.

Pika 9 e nenit 48 të Ligjit për Statusin, nuk parashikon diferenca në vlerësim ndërmjet mekanizimit të komandimit dhe delegimit si përparësi në procedurat e ngritjes në detyrë. \pra vetë ligji i konsideron të dyja përparësi por nuk bën diferencën se kush mund të ketë më tepër përparësi ndërmjet komandimit dhe delegimit.

Në lidhje me komandimin, referuar rregullores “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve” të miratuar me vendimin e Këshillit nr.70, datë 07.02.2020, Këshilli ndër të tjera ka parashikuar si “Përvojë në pozicionet e komanduara”, edhe komandimin në çdo pozicion me vendim të institucioneve të tjera, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi përpara Ligjit për Statusin.

Në një situatë të ngjashme të rrethanave faktike, pra duke iu referuar komandimit dhe jo delegimit, Këshilli ka vendosur në favor të kandidatëve që kanë pasur përparësi ose vlerë të shtuar komandimin përpara sesa kjo përparësi të konsiderohej avantazh për të në Ligjin për Statusin gjatë procedurës së ngritjes në detyrë të kandidatit.

Bazuar në pikën 9 të nenit 48 të Ligjit për Statusin, si edhe në pikën 15 të vendimit 70/2020, kur është ngritur në detyrë kandidatët të cilët kanë shprehur interes për të zhvilluar karrierën e tyre në drejtim të ngritjes së tyre në detyrë është vlerësuar si përparësi, si vlerë e shtuar komandimi që magjistratët kanë pasur (si bonus) përpara

hyrjes në fuqi të Ligjit për Statusin. Janë disa vendime të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Unë në relacion kam vendosur jo pa qëllim vendimin nr. 164, datë 05.05.2022 pasi kam qenë vetë anëtar që e kam votuar këtë vendim, por ka edhe vendime të tjera kur unë nuk kam qenë anëtar, dhe është mbajtur i njëjti qëndrim për rastet e komandimit.

A vlen kjo qasje dhe praktikë e Këshillit për rastin e një kandidati i cili ka qenë i deleguar si anëtar i Kolegjit Zgjedhor?

Pra thashë, për komandimin ne kemi pasur praktika të Këshillit. Kjo është praktika e parë në lidhje me një kandidat si anëtar i Kolegjit Zgjedhor i cili ka qenë në këtë detyrë përpara sesa Kodi Zgjedhor ta ketë konsideruar si vlerë të shtuar delegimin e tij në Kolegjin Zgjedhor.

Meqenëse ligjvënësi i trajton në mënyrë të barabartë dhe të pa diferencuar të dy mekanizmat e përparësisë (si në Kodin Zgjedhor ashtu edhe në Ligjin për Statusin) si edhe referuar zbatimit të parimit të analogjisë në shqyrtimin e çështjeve me natyrë administrative (pasi ky është rasti i parë që i referohet qenies si përparësi ose jo delegimin që i është bërë një anëtar i Kolegjit Zgjedhor), vlerësojmë në përfundim se qëndrimi dhe trajtimi i çështjes duhet të jetë i njëjtë (sipas mendimit tonë). Rrjedhimisht, vlerësojmë se delegimi i kandidatit si anëtar i Kolegjit Zgjedhor përpara ndryshimeve të Kodit Zgjedhor me Ligjin nr. 101/2020 në procedurat e ngritjes në detyrë nuk duhet të përjashtohet si kriter përparësie kur delegimi i tij është bërë përpara hyrjes në fuqi të Ligjit për Statusin si dhe para ndryshimeve të Kodit Zgjedhor.

Në këto rrethana, nëse Këshilli e konsideron vlerë të shtuar, referuar përparësisë së dytë për kriterin e parë të renditjes, pra asaj sipas “përvojës si gjyqtar i komanduar, si gjyqtar në skemën e delegimit, ose si anëtar i Këshillit”, u konstatua se njëri nga dy kandidatët me rezultate, nivele të njëjta vlerësimi etik dhe profesional, ka përvojë të tillë, konkretisht z. {...} në periudhën dhjetor 2012 deri në dhjetor 2016, pasi ai ka qenë i deleguar si anëtar i Kolegjit Zgjedhor dhe e ka përfunduar ushtrimin e kësaj detyre të ngarkuar.

Nisur nga përcaktimet pikave 8 dhe 15/b, të Vendimit 70/2020, rezulton se nga zbatimi i përparësisë së dytë për kriterin e parë të renditjes, pra asaj sipas “përvojës si gjyqtar i komanduar, si gjyqtar në skemën e delegimit, ose si anëtar i Këshillit”, arrihet të identifikohet kandidati me rezultatet më të larta, pikërisht z. {...} (nëse do ta marrim si

vlerë të shtuar qenien e tij si anëtar i Kolegjit Zgjedhor, atëherë ai ka përparësi në raport me kandidatin tjetër). Mbi këtë bazë arrihet të bëhet edhe renditja e kandidatëve, ku më lart renditet kandidati z. {...}, ndërsa kandidatja tjetër renditet pas tij.

Bazuar në sa sipër, relatori përgatiti projektvendimin paraprak “Për propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë, në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 537, datë 17.11.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Sipas pikës 1 të projektvendimit paraprak, Këshillit i propozohet të miratojë renditjen e gjyqtarëve që kandidojnë për t’u emëruar në Gjykatën e Lartë, në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 537, datë 17.11.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

- 1) Znj. {...};
- 2) Z. {...};
- 3) Znj. {...}

Sipas pikës 2 të projektvendimit paraprak, Këshillit i propozohet të vendosë propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë, në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 537, datë 17.11.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të kandidatit z. {...} që është kandidati i dytë i renditur me rezultate më larta për këtë pozicion.

Në pikën 3 të projektvendimit paraprak, përcaktohet se një kopje e arsyetuar e vendimit iu njoftohet kandidatëve znj. {...}, znj. {...} dhe z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Në pikën 4 të projektvendimit paraprak, përcaktohet se kundër vendimit mund të bëhet ankim nga çdo kandidat, në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.

Së fundi, në projektvendimin paraprak përcaktohet se ky vendim botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Projektvendimi paraprak “Për propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë, në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 537, datë 17.11.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, u shqyrtuar nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës në mbledhjen e datës 02.06.2023, dhe më pas është vendosur kalimi i çështjes për shqyrtim në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Versioni II.

Nëse Këshilli vlerëson se z. {...} nuk përfiton vlerë të shtuar apo përparësi për shkak të delegimit si anëtar i Kolegjit Zgjedhor, atëherë parashtrohet varianti II, me një tjetër konfigurim renditjeje, duke vijuar me hapin e radhës.

Për dy kandidatët e tjerë me rezultate të njëjta, konkretisht znj. {...} dhe z. {...} u ndoq hapi i renditjes referuar përparësisë së tretë për kriterin e parë të renditjes, asaj sipas “skemës së pikëve të miratuar nga Këshilli”. Për kandidatët u konstatua:

Për znj. {...} – Sipas “Raportit të vlerësimit etik dhe profesional me qëllim gradimi të gjyqtarës {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, miratuar me vendimin e Këshillit nr. 536, datë 14.12.2022, për të 4 kriteret e vlerësimit, kandidatja është vlerësuar në total me 397 pikë;

Sipas “Raportit të vlerësimit të përshpejtuar etik dhe profesional të gjyqtarës {...}, për vitin 2021”, miratuar me vendimin e Këshillit nr. 537, datë 14.12.2022, për të 4 kriteret e vlerësimit, kandidatja është vlerësuar në total me 382 pikë;

Në total, për të dy vlerësimet etike dhe profesionale, kandidatja është vlerësuar me 779 pikë.

b) Për z. {...} – Sipas “Raportit të vlerësimit etik dhe profesional me qëllim gradimi të gjyqtarit {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, miratuar me vendimin e Këshillit nr. 456, datë 02.11.2022, për të 4 kriteret e vlerësimit, kandidati është vlerësuar në total me 381 pikë;

Sipas “Raportit të vlerësimit të përshpejtuar etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për vitin 2021”, miratuar me Vendimin e Këshillit nr. 3, datë 16.01.2023, për të 4 kriteret e vlerësimit, kandidati është vlerësuar në total me 373 pikë;

Në total, për të dy vlerësimet etike dhe profesionale, kandidati është vlerësuar me 754 pikë

Nga zbatimi i përparësisë së tretë për kriterin e parë të renditjes, pra asaj sipas “skemës së pikëve të miratuar nga Këshilli”, është e mundur renditja e kandidatëve me rezultate të njëjta, si më poshtë:

1) Znj. {...} – 779 pikë;

2) Z. {...} – 754 pikë.

Nisur nga zbatimi përparësisë së tretë për kriterin e parë të renditjes, asaj sipas

“skemës së pikëve të miratuar nga Këshilli”, arrihet të identifikohet kandidati me rezultatet më të larta, mes dy kandidatëve znj. {...} dhe z. {...}, pikërisht znj. {...}.

Për pasojë renditja e kandidatëve për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 537, datë 17.11.2021 është si më poshtë:

- 1) Znj. {...};
- 2) Znj. {...};
- 3) Z. {...}.

Kandidatja e renditur më lart, znj. {...} rezulton e renditur e para në pozicionin e lirë, në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 536, datë 17.11.2021. Për rrjedhojë, në projektvendimin paraprak për këtë pozicion të lirë, ajo propozohet për emërim në Gjykatën e Lartë. Nisur nga një rrethanë e tillë, kjo konkandidate nuk mund të përzgjidhet për të vijuar procedurën edhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 537, datë 17.11.2021 sepse është përzgjedhur si konkandidate e renditur e para për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 536, datë 17.11.2021.

Për rrjedhojë, për t’u propozuar për emërim në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë, në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 537, datë 17.11.2021, mbetet kandidati i renditur pas znj. {...}, pra znj. {...}.

Bazuar në sa sipër, relatori përgatiti projektvendimin paraprak “Për propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë, në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 537, datë 17.11.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Sipas pikës 1 të projektvendimit paraprak, Këshillit i propozohet të miratojë renditjen e gjyqtarëve që kandidojnë për t’u emëruar në Gjykatën e Lartë, në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 537, datë 17.11.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

- 1) Znj. {...};
- 2) Znj. {...};
- 3) Z. {...}.

Sipas pikës 2 të projektvendimit paraprak, Këshillit i propozohet të vendosë propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë, në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 537, datë 17.11.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të

kandidates znj. {...} që është kandidati i dytë i renditur me rezultate më larta për këtë pozicion.

Në pikën 3 të projektvendimit paraprak, përcaktohet se një kopje e arsyetuar e vendimit iu njoftohet kandidatëve znj. {...}, znj. {...} dhe z.{...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Në pikën 4 të projektvendimit paraprak, përcaktohet se kundër vendimit mund të bëhet ankim nga çdo kandidat, në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.

Së fundi, në projektvendimin paraprak përcaktohet se ky vendim botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit për vëmendjen.

Naureda Llagami: Faleminderit zoti Kurushi!

Atëherë, përpara se të kalojmë në votim projekt-aktet, kemi ndonjë diskutim?

Me radhë.

Marçela Shehu: Kam një pyetje procedurale në fakt.

Duke qenë se relatori, me të njëjtin relacion i paraqiti për shqyrtim mbledhjes plenare dy projektvendime, tre projektvendime, duke qenë se një propozim është me dy variante, kam një pyetje apo paqartësi në lidhje me përfshirjen në të njëjtën mbledhje. Si është menduar nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, pse nuk duhet pritur marrja formë të prerë e vendimit të parë për propozimin në Gjykatën e Lartë, përpara se të kalojmë tek vendimi i dytë? Në të dyja projektvendimet, ne i japim të drejtë kandidatëve që të ankimojnë vendimin për propozim. Janë tre kandidatë për të dyja procedurat. Në pikën 4 të secilit projektvendim thuhet që kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim nga secili kandidat në Gjykatën Administrative të Apelit brenda 5 ditëve nga dita e njoftimit të vendimit. A nuk do të ishte më mirë, nga pikëpamja procedurale, që vendimi i parë (pra që propozohet zonja {...}) të merrte formë të prerë, dhe më pas të kalojmë në vendimin e dytë? Mbase ka një përgjigje. Ky nuk është një propozim.

Naureda Llagami: Atëherë, përpara se t’ia jap fjalën kolegut tjetër për pyetje, zoti

Kurushi, një përgjigje?

Klodian Kurushi: Po, atëherë, unë mund të them se, meqenëse të dyja pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 536 dhe nr. 537 kishin mbaruar të gjitha procedurat e tjera të vlerësimit etik dhe profesional, u morën edhe vlerësimet e tyre, atëherë ne nuk mund të prisnim, por ishim të gatshëm për të vijuar më tej procedurën sipas ligjit edhe rregullores përkatëse nr. 70/2020, për të vijuar më tej procedurën e përzgjedhjes.

Në këtë pikë, ne nuk gjenim ndonjë rrethanë, arsye pse duhet të çonim në Këshill përpara njërin, duke diferencuar njërin pozicion të lirë nga pozicioni tjetër i lirë, ku referuar rrethanave ligjore dhe atyre të parashikuara në vendim, ne kishim për detyrë që të sillnim projektvendimet përkatëse për përzgjedhjen e kandidatëve në këto dy pozicione të lira të mbetura pa u përzgjedhur kandidati. Faleminderit!

Marçela Shehu: Të lutem, nëse më pranon edhe një pyetje tjetër.

Në rastin eventual që një nga kandidatët do të ankimonte këtë projektvendim dhe Gjykata Administrative e Apelit të ndryshonte/prishte (pra duhet të kemi parasysh çdo skenar të mundshëm që mund të ndodhi), ky vendimi i gjykatës a do të afektonte ecurinë apo atë çka ne disponojmë me vendimin e dytë pastaj për pozicionin tjetër?

Klodian Kurushi: Faleminderit edhe për pyetjen e dytë.

Edhe për pyetjen e dytë po jap këtë përgjigje.

E para, ne nuk mund të hamendësojmë do bëhet ankim apo nuk do bëhet ankim për këto vendime. E dyta, nëse do bëhet ankim për këto dy vendime, nuk mund të hamendësojmë vendimin e gjykatës, do dakordësohet me konkluzionet dhe vendimmarrjet tona apo do t'i ndryshojë këto vendime. Edhe në hamendësimin e tretë, nëse do t'i ndryshojë këto vendime, do shikojmë vendimet e gjykatës, çfarë do thotë në lidhje me procedurat që kemi ndjekur ne. Ne do t'i referohemi gjithmonë vendimeve të gjykatës, çfarë do thotë gjykata në këto raste.

Marçela Shehu: Dua ta sqaroj proceduralisht, sepse mendoj që edhe për Këshillin është i rëndësishëm që ky moment procedural të jetë i qartë, pse nuk po pritet marrja

formë të prerë e një vendimi, për të kaluar tek vendimi tjetër. Kaq. Nëse mendojmë që këto të dyja nuk e afektojnë procedurën e njëra-tjetrës, jemi dakord të vazhdojmë. Nuk po paraqes një kërkesë. Po hedh një diskutim dhe mendoj që diskutimi është i drejtë sepse nuk është shqetësimi im, është i të gjithë Këshillit. Pra nëse nuk presim afatin 5-ditor të ankimit, nuk cenohet procedura vijuese, nuk ka më një propozim. Prandaj e bëra pyetjen zoti Kurushi.

Klodian Kurushi: Po vazhdoj ta sqaroj.

Nuk e dimë se çfarë do ndodhi në gjykatë nëse ndonjë nga kandidatët... (i ndërpritet fjala).

Marçela Shehu: Më fal, ato mund të jenë të dyja në fuqi.

Më fal se të ndërpreva.

Parashikoj një situatë shumë hipotetike që mund të ndodhi.

Klodian Kurushi: Më lër të marrë situatën hipotetike më të keqe për neve, pra që të na vërë ne në pozitë të vështirë.

Vazhdoj të them, do t'i referohemi vendimit të gjykatës. Vendimi i gjykatës absolutisht që do zgjidhi këtë problem, si të njërit pozicion, por jam i bindur që do të trajtojë edhe pozicionin tjetër lidhur me pozicionin e parë. Por nuk e dimë se si do shqyrtohen dhe se si do ankohen. Unë këto nuk i di. Mbase ankimohet i dyti dhe s'ankimohet i pari. Ne kemi vetëm detyrimin ligjor që, me mbarimin e situatës së vlerësimeve duhet të çojmë relacionin.

Naureda Llagami: Zoti Kurushi, tek rregullorja nuk kemi ndonjë dispozitë që parashikon në rast se kemi të njëjtat kandidatura.

Brikena Ukperaj: Ndoshta, Marçela dhe Albani, duke qenë se kanë qenë edhe më herët anëtarë të Komisionit të Karrierës, mund ta kenë më të freskët informacionin, por mund të them nga ajo që unë mbaj mend. Kryesisht ne kemi pasur rastet e pozicionit të penales në Gjykatën e Lartë dhe një rast tjetër kemi pasur pozicionet e civilese ose të

administratives, por për penalen jam e sigurt, ku ne në të njëjtin relacion dhe në të njëjtën ditë ke i miratuar projektvendimet e renditjes për të katër pozicionet e penales. Për penalen e mbaj mend me siguri dhe kemi ndjekur të njëjtën logjikë (meqenëse renditej i pari në një pozicion, shmangej renditja tek i dyti, shmangej tek i treti dhe tek i katërti). Pasi kemi miratuar renditjen, nuk kemi pasur ankimime dhe kemi vazhduar pastaj me propozimet.

Unë këtë e mbaj mend për procedurë.

Për pozicionet e penales jam e sigurt.

Alban Toro: Kam përshtypjen Brikena se i kemi njoftuar me e-maile.

Brikena Ukperaj: E-mailet janë kur ti i njofton projektvendimin e renditjes.

Sigurisht që pasi t'ia njoftosh projektvendimin e renditjes, gjyqtari mund të ketë ankim (ata nuk kanë pasur ankim), dhe ne pastaj kemi vazhduar me propozimin, në të njëjtën ditë. Duhet të ketë qenë edhe zoti Kurushi ndoshta në katër propozimet dhe ndoshta e mban mend, keni qenë me një relacion të katër kandidatët e penales, në një ditë.

Është bërë përzgjedhja për katër... këtë e mbaj mend. Këtë praktikë kemi ndjekur. Edhe me idenë sepse ne duhet të operonim sa më shpejt, për të bërë edhe Gjykatën e Lartë sa më shpejt funksionale. Për këtë arsye. Gjithsesi, edhe aty është i njëjti diskutim, kanë qenë të njëjtët kandidatë. Këtë mbaj mend, për ta sjellë në kujtesën tuaj.

Marçela Shehu: Unë nuk e mbaj mend.

E para, nuk e dimë, ato katër pozicione të penales a kanë qenë të njëjtët kandidatë.

Brikena Ukperaj: Të njëjtët kandidatë kanë qenë.

Marçela Shehu: Po flasim për dy projekt-akte ku janë tre kandidatë, janë të njëjtët kandidatë, e para. E dyta, i është marrë një konfirmim që nuk kanë ankim për vendimin e gjykatës.

Brikena Ukperaj: Ankimimi është mbas vendimit të renditjes.

Marçela Shehu: Jam dakord pra. Po ky pra është vendimi i renditjes.

Brikena Ukperaj: Po pra, e bëjmë sot në të njëjtën ditë dhe pastaj presim ankimimin, pastaj propozimin për Presidentin.

Marçela Shehu: Ky projektvendimi i parë afekton projektvendimin e dytë. Më kupton? Këtë po them.

Brikena Ukperaj: Në të njëjtën ditë, tek penalja, kemi marrë katër projektvendime renditjeje për katër pozicione dhe kemi pasur të njëjtët kandidatë, sepse të katër kandidatët që ishin, të katër shkuan, me përjashtim të një gjyqtari që dha dorëheqjen mbaj mend në fund të procedurës. Pra ne, në të njëjtin relacion, kemi miratuar katër renditje për katër pozicione. Ju kemi dhënë mundësinë... (i ndërpritet fjala).

Marçela Shehu: E pra, kanë qenë katër kandidatë për katër pozicione dhe secili e kanë pasur të qartë se ku do shkonte.

Brikena Ukperaj: Nuk ishte shumë e qartë se si do bëhesh.

Marçela Shehu: Gjithsesi nuk kam një kërkesë.

Unë po ngre një shqetësim, nesër mund të jetë shqetësim. Nuk e di?!

A afekton kjo gjë pozicionin tjetër apo jo? Nëse jo, vazhdojmë me votimin.

Naureda Llagami: E para, se kemi dy kërkesa.

Besoj se z. Kurushi e dha përgjigjen për kërkesën e zonjës Shehu.

Fjalën në fakt z. Hallunaj, e ka i pari Ridvani, se e kishte kërkuar më përpara.

(Gjithsesi, fjalën e merr përpara zoti Hallunaj.)

Dritan Hallunaj: Pyetjes nëse e afekton: Për mendimin tim dhe ky është qëndrimi

që kam mbajtur edhe në Komision, nuk e afekton fare, pasi {...} (kandidatja) është në të dy vlerësimet "Shkëlqyeshëm" dhe plus ka pjesën që nuk e diskuton njeri, pjesën e komandimit. Ndërsa për dy kandidatët e tjerë z. {...} dhe znj. {...} që mendoj që nuk kanë pretendime për këtë pozicionin ku është {...}, pasi është më lart me vlerësim. "Lufta" bëhet midis këtyre të dyve po themi. Pra përjashtohet kjo dhe ngelin këto të dy. Kështu që unë mendoj që nuk ka pse afekton vendimmarrja, pra pozicioni 536 me 537. Kështu që normalisht duhet të vijojmë. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit zoti Hallunaj!

Po, zoti Hado!

Ridvan Hado: Lidhur me sa diskutohet dua të them, për sa i përket renditjes, znj. {...} ka nivelin e vlerësimit më të lartë se dy kandidatët e tjerë dhe s'kemi çfarë diskutojmë për këtë pasi ka dy vlerësime "Shkëlqyeshëm". Për sa i përket dy kandidatëve të tjerë për dy vendet vakante në Gjykatën e Lartë, z. {...} dhe znj. {...}, meqenëse janë të njëjtin nivel vlerësimi pasi kanë një vlerësim "Shkëlqyeshëm" dhe vlerësimin e fundit e kanë "Shumë mirë" të dy; diskutimi që shtrohet është nëse do kalojmë tek përparësia e dytë; do e konsiderojmë periudhën ku zoti {...} ka qenë anëtar i Kolegjit Zgjedhor nga viti 2012–2016 apo jo? – nisur nga fakti i ndryshimeve të pësuar në ligjin për zgjedhjet në Republikën e Shqipërisë Kodi Zgjedhor, dispozita përkatëse, që e konsideron vlerë të shtuar, përvojë për qëllim ngritjeje në detyrë, si dhe ndryshimin që është bërë në ligjin tonë "Për statusin" në dispozitën për procedurën e lëvizjeve paralele.

Unë jam i mendimit që, nëse do kenë fuqi prapavepruese këto dispozita apo s'do kenë fuqi prapavepruese? Nëse legjislatori do donte që këto dispozita të kishin fuqi prapavepruese, do e kishte zgjidhur këtë me një dispozitë kalimtare.

Nga ana tjetër, pyetja që më lind mua është: Nëse ne do ta bënim vlerësimin jo në këtë kohë, mbas ndryshimeve ligjore, por do ta bënim përpara ndryshimeve ligjore, do ta konsideronim vlerë të shtuar apo jo? Unë mendoj që jo. Efektet ligjore të dispozitave të ndryshuara janë nga momenti që kanë hyrë në fuqi e në vijimësi. Kështu që duhet të kalojmë në përparësinë e tretë në nivelin e pikëzimit, krahasimin e nivelit të pikëzimit.

Nga ana tjetër nuk rri dot pa shtuar që nëse nuk do bazoheshim në rregullat e

sipërcituara, nëse do ishim në parimet e vlerësimeve që do ishte në pushtetin e këtij Këshilli, nisur nga parimi i dinjitetit të vjetërsisë apo profesionalizmit, unë do votoja të parin z. {...}, për arsyen e thjeshtë se zoti {...} është një nga gjyqtarët më të vjetër të republikës, gjyqtari më i vjetër në gjykatat e apelit, gjithashtu është gjyqtar me shumë profesionalitet dhe gjyqtar dinjitoz. Kaq kisha. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit z. Ridvan!

Në fakt z. Ridvan kaloi në një diskutim tjetër që ka të bëjë me propozimet që ka sjellë vetë Komisioni që ka ardhur me dy propozime lidhur me renditjen e kandidatëve.

Në fakt, nuk e di nëse, sepse duke qenë se vetë Komisioni i ka sjellë të dy propozimet, atëherë a do afektonte propozimi i renditjes së dytë edhe renditjen e parë formalisht?

Irena Plaku: Pasur parasysh edhe diskutimin nga zoti Ridvan, ishte një pyetje në fakt për relatorin, se kush është propozimi i tyre? Nga renditja e relacionit duket sikur është propozimi i parë për marrjen e përparësisë, pastaj është propozimi tjetër. Tani fiks fare unë nuk e kuptoj kush është propozimi i relatorit. Kështu që duhet të jetë pak e qartë, dhe më pas kalojmë tek diskutimi tjetër. Kush është propozimi juaj, propozimi për Këshillin? Se kenë ardhur me dy versione.

Naureda Llagami: E ka fjalën Klodi për t'i kthyer përgjigje. Pastaj e ka Albani dhe pastaj e ka Marçela.

Klodian Kurushi: Atëherë, për ta sqaruar edhe një herë, se unë mendova që ka qenë e qartë ajo çfarë kam shkruar unë, por duhet sqaruar edhe pak më tej.

Thashë edhe një herë, propozimi i parë është ai ku bën renditjen e {...} të parën (për pozicionin nr. 537 flasim), i dyti është {...} dhe e treta është {...}. Pse? E morëm thashë si vlerë të shtuar referuar standardit që ka mbajtur Këshilli i Lartë Gjyqësor në raste të tjera të ngjashme ku ka marrë si vlerë të shtuar komandimin. Meqenëse ligji thashë nuk ka bërë diferenca mes komandimit dhe delegimit me njëri-tjetrin, për sa kohë ne dhe unë personalisht kam votuar për komandimin si vlerë të shtuar për një gjyqtar në

Gjykatën e Lartë, atëherë nuk shoh situata të diferencuara midis komandimit dhe (ky është rasti i parë që ne marrim në shqyrtim) qenies i deleguar si anëtar i Kolegjit Zgjedhor. Meqenëse ligji e ka thënë që kjo është vlerë e shtuar dhe këtë ne nuk e diskutojmë me njeri-tjetrin (për 2020 e më tej), por a ka efekte prapavepruese? Dhe unë thashë shembullin e që e kam votuar vetë, e kam thënë qëllimisht si shembull se e kam votuar vetë. Po të doni mund të jap edhe një shembull tjetër, kur kam kandiduar vetë. Një nga kolegët tanë që ka qenë e komanduar para se të hynte në fuqi ligji “Për statusin” mori edhe ajo përparësitë e veta, i është dhënë nga Këshilli efekt prapaveprues. Është mbajtur një standard nga Këshilli. Kjo është situata që mua më bën të shkoj më shumë tek pjesa e bonusit, e përparësisë që merr delegimi, për sa kohë ligji nuk ka bërë diferenca mes vlerës shtuar midis komandimit dhe delegimit. Por që është një çështje e diskutuar, absolutisht, se nuk është shumë e qartë. Edhe tani kemi diskutime. Kështu që unë s’ mund ta leja versionin e dytë pa bërë. I pari është ky që thashë, ku e kam vënë edhe në “footnote” (futnot), që kam votuar vetë, për të parin. I dyti është nëse nuk pranohet kjo si vlerë e shtuar, pastaj do ndjekim përparësitë e tjera.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit zoti Kurushi!

Atëherë, fjalën e ka zoti Toro.

Alban Toro: Një sqarim për praktikën që kemi mbajtur më përpara.

Zakonisht kemi operuar me e-maile me gjyqtarët të cilët janë renditur, për të pritur konfirmimet, që nuk kanë pasur ankim për këtë pjesë.

A do të afektonte kjo apo s’do të afektonte, mund ta shoqëroj me faktin që t’i japim një kohë të mjaftueshme kandidatëve në rastin konkret, t’i merret një konfirmim nëse do ta ankimojnë të dy vendimet, të mos veprojmë më pas me stadin e dytë, duke pritur që të mbarojë konfirmimi apo të merret konfirmimi si nga gjykata apo nga kandidati që nuk do të ankimojë vendimin për të cilin po diskutojmë.

Naureda Llagami: Kjo kishte të bënte me çështjen që ngriti Marçela.

Alban Toro: Formalisht duhet pritur.

Nga pikëpamja ekonomike e kohës mund të operojmë që t'i japim një kohë më të mjaftueshme dhe t'i marrim një konfirmim patjetër që të mund të vazhdohet.

Naureda Llagami: Pas vendimmarrjes së parë thotë Albani.

Alban Toro: Pas vendimmarrjes së parë.

Naureda Llagami: Por Komisioni ka mbajtur qëndrim tjetër përderisa i ka përcjellë mbledhjes plenare të dyja bashkë.

Diskutim tjetër, përpara se të kalojmë në votim sipas radhës së projekt-akteve që ka propozuar edhe Komisioni, keni?

Atëherë, kalojmë projekt-aktin e parë. Jemi dakord me propozimin e ardhur nga Komisioni për renditjen?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e renditjes së gjyqtarëve që kandidojnë për t'u emëruar në Gjykatën e Lartë, në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 536, datë 17.11.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

1) Znj. {...};

2) Znj. {...}; Z. {...};

2. Propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë, në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 536, datë 17.11.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të kandidates znj. {...}.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit iu njoftohet kandidatëve: znj. {...}, znj. {...} dhe z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

4. Kundër vendimit mund të bëhet ankim nga çdo kandidat, në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.

Ky vendim botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë tek projekt-akti i dytë për të cilin Komisioni ka sjellë dy propozime. Filloi diskutimi në fakt për këtë projekt-akt. Nëse ka ndonjë koleg tjetër për të diskutuar apo i hedhim në votim sipas radhës së përcjellë nga Komisioni?

Po zonja Ukperaj!

Brikena Ukperaj: Faleminderit zonja Kryetare!

Paraprakisht dakordësohem me propozimin e sjellë nga Komisioni për ta konsideruar përparësi dhënien e kontributit të gjyqtarit si anëtar i Kolegjit Zgjedhor, por mendoj që ka rëndësi për të dhënë edhe një argumentim shtesë ose ndryshe nga ajo që është bërë në këtë relacion, duke qenë se kam edhe një përvojë ndoshta para se zoti Kurushi të ishte anëtar i Këshillit.

Fillimisht ligji “Për statusin” nuk e parashikonte si përparësi kontributin e gjyqtarit si anëtar i Kolegjit Zgjedhor, dhe dua të ndalem këtu që të jemi të rregullt me termat sepse jemi juristë.

Në fakt, nuk është përparësi delegimi apo komandimi. Delegimi dhe komandimi janë mekanizma ligjorë. Ne juristët përdorim dallimin midis faktit juridik dhe marrëdhënies juridike. Përparësi është marrëdhënia juridike. Përparësi është dhënia që gjyqtari jep në skemë delegimi në një institucion ku ai është i komanduar apo më pas edhe si anëtar i Kolegjit Zgjedhor.

Në momentin kur ne kemi bërë rregulloren për ngritjen në detyrë, parashikimet e

Kodit Zgjedhor nuk ishin në fuqi, nuk kishte ndodhur parashikimi. Në vitin 2020, Kodi Zgjedhor ndryshon me ligjin e cituar nga ana e relatorit dhe në një dispozitë të posaçme, neni 149 parashikon disa situata të cilat konsiderohen mbrojtje e posaçme për gjyqtarët e kolegjit, midis tyre ishte “anëtari i kolegjit nuk i nënshtrohet hetimit dhe procedimit disiplinor”, “nuk lëvizet nga detyra në mënyrë të përhershme apo të përkohshme për shkaqe organizimi gjyqësor dhe duke mbajtur qëndrimin pa pëlqimin e tij”, “nuk mund të vlerësohet “i pamjaftueshëm” për aftësitë profesionale gjatë kohës që është anëtar i Kolegjit Zgjedhor” dhe njëkohësisht bonusi tjetër që është në paragraf më vete është “pas përfundimit të delegimit në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, ushtrimi i detyrës në këtë kolegji konsiderohet vlerë e shtuar në përvojë për qëllimet e ngritjes në detyrë”.

Pas miratimit të Kolegjit Zgjedhor me këtë bonus të ri për gjyqtarin, ne si Këshill ngritëm një grup pune për të bërë disa ndryshime në ligjin “Për statusin” dhe në këtë grupin e punës të asistuar edhe nga misionet tona mbështetëse (në atë kohë ka qenë USAID dhe EURALIUS) bashkë me misionet që mbështesnin Ministrinë e Drejtësisë, u propozuan disa ndryshime për të reflektuar në ligjin e statusit (ndryshimet e vitit 2021). Në këto ndryshime që ne propozuam donim që të afektonin edhe parashikimet që ishin bërë me ligje të posaçme. Tani pse nuk u bë tek neni i “ngritjes në detyrë” por u bë tek “lëvizja paralele”? Nuk u bë për arsye sepse Kodi Zgjedhor është një ligj me 3/5. Për efekt të hierarkisë së ligjeve ai barazohet me ligjin “Për statusin”. Ndërkohë mbrojtja e posaçme e gjyqtarëve, anëtarë të Kolegjit Zgjedhor, parashikohet në ligjin specifik të tyre, pra parashikohet pikërisht në Kodin Zgjedhor, dhe për të mos bërë dublim të parashikimeve ligjore të Kodit Zgjedhor me ligjin “Për statusin”, nuk u shtua në ligjin “Për statusin” përparësia si anëtar i Kolegjit Zgjedhor si përvojë në Kolegjin Zgjedhor, por u mendua që jo në një interpretim analogjik por në një interpretim sistematik të dy dispozitave në fakt ky parashikim përbënte një përparësi të re, nuk ishte skemë delegimi, nuk ishte komandim, ishte kontribut i gjyqtarit si anëtar i Kolegjit Zgjedhor, dhe kjo përparësi e re duhet të konsiderohet e shtuar ndër përparësitë që parashikonte ligji “Për statusin”. Me këtë arsyetim dhe për t’i dhënë të njëjtin kuptim juridik/të njëjtën pasojë juridike termit “vlerë e shtuar” dhe “përparësi” ne propozuam që tek dispozita e “lëvizjes paralele” të shtohen të gjitha përparësitë tashmë që gjyqtari qoftë kur ngrihet në detyrë qoftë kur shkon me lëvizje paralele të ketë të njëjtat përparësi. Kjo ka qenë arsyeja që u

parashikua tek “lëvizja paralele” dhe jo tek “ngritja në detyrë”, që të mos kishim dublim të parashikimeve ligjore. Në atë kohë ne ramë dakord dhe ligjvënësi ka pranuar propozimet tona që termi “përparësi” dhe termi “vlerë e shtuar” janë e njëjta gjë, pra qenia anëtar i Kolegjit Zgjedhor është një përparësi e tretë në interpretim sistematik të të dy dispozitave. Përparësi sot është skema e delegimit, përparësi është kontributi si i komanduar në një institucion, përparësi është përvoja e gjyqtarit në Kolegjin Zgjedhor. Kjo ka qenë arsyeja.

Tani, a do të ketë efekte prapavepruese apo nuk do të ketë efekte prapavepruese?

Në fakt ne këtë diskutim e kemi ngritur që kur miratuam rregulloren e ngritjes në detyrë dhe patëm edhe shumë diskutime dhe parimi që mori më shumë vota ka qenë ai i garantimit të ruajtjes së një statusi juridik për sa i përket karrierës së gjyqtarit. Gjyqtari nuk e fillon karrierën në 2016, as në 2020. Gjyqtari ka një karrierë edhe para 2016 edhe para 2020. Kjo ishte arsyeja që ne thamë që për të trajtuar në të njëjtën mënyrë të gjithë gjyqtarët, përparësitë e tyre do të shikohen pavarësisht kohës se kur ka ndodhur, para hyrjes në fuqi të statusit apo edhe të Kolegjit Zgjedhor.

Për këtë arsye dhe me këtë argumentim unë mendoj... Parimit të trajtimit të barabartë për efekt të karrierës së gjyqtarit. Gjyqtari karrierën e tij nuk e fillon në 2016-ën dhe ne duhet të zhvlerësojmë të gjithë kontributet që gjyqtari ka dhënë para 2016-ës apo gjyqtarët që kanë dhënë kontribut në Kolegjin Zgjedhor para 2020-ës. Edhe ato pa dyshim që përbëjnë vlerë të shtuar/përparësi.

Për shkak të këtij arsyetimi, unë vlerësoj që varianti i parë i ardhur nga ana e Komisionit të Karrierës për pozicionin 537 lidhur me renditjen e kandidatëve, ku zoti {...} për shkak përparësie duhet të renditet para gjyqtares {...}, mendoj që është në përputhje me ligjin.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Ndonjë diskutim tjetër?

Po, zoti Toro!

Alban Toro: Ashtu siç tha edhe kolegja, bëhet fjalë që t'i japim fuqi

prapavepruese/retroaktive përparësisë së re që është krijuar me ndryshimet së fundi të ligjit që trajton Kolegjin Zgjedhor i cili ka hyrë në fuqi në gusht të 2020-ës. Ndërkohë, po me një akt tonin normativ, ne kemi prodhuar një ligj të veçantë ku i kemi dhënë përparësi komandimit të kryer përpara hyrjes në fuqi të ligjit “Për statusin”, për të cilin të paktën moralisht kam qenë tek ata anëtarë që kam debatuar dhe kam votuar kundër sepse ka disa probleme ligjore edhe ky fakt, që ne kemi shtuar atë që s’e ka ligji, duke konvertuar këtë institucion me disa institucione të tjera të ngjashme që kur mungon ligji, i prodhojnë rregullimet me vendime të veçanta.

Gjithsesi, më duhet të ndalem, e para, parashikimi i kësaj përparësisë së re nuk rezulton të jetë tek vendimi ynë nr. 70, germa “f”, dhe për shkak të analogjisë po tentojmë ta përfshijmë si kontribut apo si vlerë të shtuar edhe tek renditja aktuale. E para, nuk bën pjesë tek akti normativ. E dyta, edhe ky sforcim do ta konsideroja unë, që me anë të analogjisë juridike mund të përfshihet si vlerë e shtuar, nuk qëndron (*e bërë nga kolegu*). Analogjia është një formë e interpretimit të ligjit kur mungon një dispozitë e caktuar, dhe një dispozitë e trajton atë fakt juridik në mënyrë të ngjashme dhe ne e përdorim; ose kur mungon kjo dispozitë ligjore, por ne përdorim parimet e përgjithshme të sistemit juridiko-civil, në rastin konkret po përdorim të sistemit juridiko-civil për të treguar që për hir të barazisë, për hir të karrierës, ne po tentojmë që magjistratit t’ia sigurojmë këtë, edhe në kohën kur është krijuar kjo marrëdhënie nuk ka ekzistuar ajo përparësi. Në këto kushte, kjo lloj ndërhyrjeje, të cilën disa mund ta konsiderojnë pozitive dhe për disa mund të jetë edhe diskriminuese, bie në kundërshtim me disa parime themelore. Parimi i parë është çështja e retroaktivitetit apo fuqia prapavepruese të cilën ne tentojmë t’i japim aktit. Mos harrojmë që neni 105 i Kodit të Procedurës Administrative i ligjit 44/2015 i ka parashikuar momentet kur një akt administrativ ka fuqi prapavepruese dhe është kur akti nxirret në zbatim të një vendimi gjyqësor që ka deklaruar si të pavlefshëm një akt administrativ; kur vetë ligji i posaçëm i jep fuqi prapavepruese, organi publik është i detyruar ta nxjerrë aktin me fuqi prapavepruese; dhe kur organi publik kompetent mund t’i japë fuqi prapavepruese aktit kur kjo lejohet nga ligji dhe është në favor të palëve të interesuara dhe nuk dëmton të drejtat e një pale të tretë, që është rasti flagrant aktual, sepse ne po dëmtojnë një palë të tretë që është konkurrues. Për mos thënë pastaj vendimin e Gjykatës së Lartë (nr. 7/2005) i cili e ka

trajtuar fuqinë prapavepruese të aktit dhe ndër të tjera arsyeton që: ...për të arritur në këtë përfundim unifikues, Kolegjet e Bashkuara pranojnë se fuqia prapavepruese e ligjit është e lidhur kryesisht me ligjin material dhe ajo nuk është në natyrën e ligjit procedural. Është vetë ligji procedural ai që duhet të përcaktojë se si duhet vepruar me rastin e hyrjes në fuqi të tij. Nisur nga fakti që nuk ka një dispozitë kalimtare në ligjin nr.9235, 29.07.2004 (ligji për kthimin e pronave) i cili është në vetvete një ligj që përmban dispozita materiale dhe procedurale, si dhe faktin që marrëdhënia juridike dhe mosmarrëveshja për to kanë lindur para hyrjes në fuqi të ligjit, ligji i aplikueshëm do të jetë ligji i kohës. Palët nuk mund të parashikonin se ligji do të ndryshonte dhe se rregullat e vendosura do të ndryshonin pasi organet kompetente kishin ndërruar funksionin e tyre. Të pranosh të kundërtën është me pasoja të rënda jo vetëm për palët të cilët gjatë apo në përfundim të ndjekjes së procedurave ligjore do detyrohen të ndjekin të tjera.

Pra një institucion i rëndësishëm të interpretimit të ligjit e konsideron të rrezikshëm këtë fuqinë prapavepruese po kështu edhe Kodi i Procedurës e ndalon në mënyrë të shprehur.

Kalojmë tek parimi tjetër që është parimi i sanksionuar latin “tempus regit actum”, është procedimi administrativ – Sipas këtij parimi, procedimi administrativ rregullohet sipas këtij parimi, sipas të cilit ligjshmëria e aktit administrativ do të duhet të vlerësohet në bazë të normës në fuqi në kohën kur akti është kryer. Kanë bërë një interpretim të elaboruar doktrinar shumë autorë por mund ta gjeni akoma më të elaboruar në një vendim të Gjykatës së Lartë italiane të 17 shkurtit 2020, me nr. 1199. Nuk është nevoja ta citoj sepse është thjesht për të elaboruar këtë që thashë.

Pra të gjitha këto argumente nënkuptojnë që për analogji bien në kundërshtim me të dy parimet, si atë që në momentin e krijimit të aktit duhet parë ligji i kohës por edhe me fuqinë prapavepruese të cilën ne po tentojmë t’i japim, i cili nga pikëpamja formale por edhe ligjore ishte krejtësisht i gabuar.

Por mos të harrojmë pastaj që tentojmë të themi delegimi tek Kolegji Zgjedhor qenka e njëjtë me skemën e delegimit vullnetar të parashikuar nga 45-sa, i ligjit “Për statusin”, ndërkohë që janë dy institute krejt të ndryshme, është i ndryshëm edhe me institutin e komandimit (nuk ka asnjë lidhje). Vetë ligji kur ka dashur i ka dhënë përparësi si njërit dhe tjetrit. Në rastin konkret Kolegjit Zgjedhor i ka dhënë përparësi të re në vitin

2020 dhe ka lejuar që të marri vlerë të shtuar, por nuk ia ka integruar ligjit “Për statusin”. Të dy ligjet janë bërë me 3/5. Tek ligji “Për statusin” ka shkuar tek “lëvizja paralele” (43), duke përfshirë si formë të vlefshme përparësie. Tek ligji “Për Kolegjin Zgjedhor” është mjaftuar me atë parashikim duke i dhënë vlerë të shtuar por gjithmonë për marrëdhëniet që kanë lindur pas 2020-ës, jo përpara për fat të keq.

Kështu që ne këtë pjesë edhe ky interpretim sa do interpretim që t’i japim është i paplotë dhe nuk mund të derivojmë apo të finalizojmë opinionin që duhet të marri patjetër përparësi.

Në lidhje me ndryshimet që ne kemi bërë, ndryshimet ligjore që ne kemi bërë, kur kemi propozuar, vetë ministri kur i është drejtuar Parlamentit me shkresën e tij “Kërkesë për inicimin e procesit ligjor për shfuqizimin e pikës /a/ dhe /b/ të pikës 1 të nenit 149 të ligjit 10019, etj., etj. të Kolegjit Zgjedhor” nuk e ka parashikuar fare këtë lloj, sepse nuk ka qenë fare i rëndësishëm pjesa e përparësisë dhe si rrjedhim edhe ligjvënësi prandaj nuk është sensibilizuar ta përfshijë në ligjin “Për statusin” por ka ngritur si argumentim/çështje imediate, që ishte krijimi i Gjykatës së Lartë dhe asaj kushtetuese. Vetë ai shprehet që nga ana tjetër ky parashikim (bëhet fjalë për pengimin e gjyqtarëve për t’u ngritur në detyrë, përveçse është antikushtetues) krijon dhe problemin e menjëhershëm në ngritjen e Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese. Siç jeni në dijeni, Këshilli i Lartë Gjyqësor është duke përmbyllur procedurat për plotësimin e vendeve vakante në Gjykatën e Lartë nëpërmjet ngritjes në detyrë të gjyqtarëve që plotësojnë kushtet për t’u emëruar në Gjykatën e Lartë. Një pjesë e kandidatëve që kanë paraqitur kërkesë për t’u ngritur në detyrë në Gjykatën e Lartë janë zgjedhur nëpërmjet shortit si anëtarë të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor. Në këtë mënyrë, pavarësisht vullnetit të tyre për shkak të parashikimit antikushtetues të shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 149 të Kodit Zgjedhor, këtyre gjyqtarëve i ndalohet vijimi i procedurave për ngritje në detyrë. Nga ana tjetër, për Këshillin e Lartë Gjyqësor krijohen vështirësi për përzgjedhjen e kandidatëve në Gjykatën e Lartë për shkak të uljes së numrit të kandidatëve që mund të aplikojnë për ngritje në detyrë. Vonesat dhe vështirësitë në zgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të rinj të Gjykatës së Lartë kanë pasojë të drejtpërdrejta dhe në plotësimin e atyre vendeve vakante të Gjykatës Kushtetuese të cilët emërohen nga Gjykata e Lartë në përputhje me nenin 125, pika 1 e Kushtetutës. Për pasojë, këto parashikime të Kolegjit

Zgjedhor paraqesin një pengesë të qenësishme në mirëfunksionimin e dy institucioneve kushtetuese në avancim të objektivave të reformës në drejtësi si në plotësimin e kërkesave të paraqitura nga Këshilli i Çështjeve të Bashkimit Evropian për t'u plotësuar përpara Konferencës së Parë Ndërqeveritare.

Pra ky ka qenë shkaku kryesor që me urgjencë janë bërë ndryshimet në ligjin “Për Kolegjin Zgjedhor” por edhe në ligjin “Për statusin” dhe ligjvënësi (që normalisht është më i ditur se ne) ka preferuar të mos e integrojë tek procedura e “ngritjes në detyrë” këtë parashikim por ta lejojë deri tek “lëvizja paralele”. Pra siç e thashë, fuqia për miratimin e të dy ligjeve është e njëjtë, 3/5, dhe nuk kishte asnjë problem që ai mos ta inkorporonte edhe tek 48-ta. Nuk e ka bërë. Tregon që ka ometuar.

Tani t'i japim fuqi prapavepruese, të shkelim edhe parimin e aktit administrativ, të krijohet kur është ligji, më duket shumë e tepërt për ta miratuar variantin e parë. Kështu që unë personalisht do të isha për variantin e dytë.

Naureda Llagami: Faleminderit zoti Toro!

Atëherë, kemi ndonjë diskutim tjetër?

Po!

Fatmira Luli: Atëherë, unë e gjykoj dhe ndaj mendim ndryshe për dispozitën që duhet të zbatohet dhe përparësinë që duhet t'i japim në këtë renditje kandidatëve dhe dispozitën përkatëse të Kodit Zgjedhor e interpretoj që brenda përmbajtjes së kësaj dispozite nuk parashikohet afati kur duhet... nëse do kishte qëllim legjislatori që t'i jepte vetëm vendimeve të Kolegjit Zgjedhor pas datës së miratimit të ligjit, do ta thoshte. Mënyra se si është formuluar kjo dispozitë të lë të kuptosh që të tërë personat që kanë qenë të deleguar në Kolegjin Zgjedhor kanë të drejtë të përfitojnë nga kjo përparësi dhe konkretisht pas përfundimit të delegimit në Kolegjin Zgjedhor, thotë dispozita, ushtrimi i detyrës në kolegji konsiderohet vlerë e shtuar në përvojë për qëllime të ngritjes në detyrë. Kjo nuk e kufizon në kohë as para as mbrapa dhe jemi në kushtet kur ligji, ashtu siç e citoi kolegu, që Kodi i Procedurave Administrative parashikon efektin prapaveprues. Në këtë dispozitë është e parashikuar dhe nuk është vënë kufi për kohën e hyrjes në fuqi. Është lënë e lirë. Të tërë personat/gjyqtarët që kanë pasur eksperiencë, kanë qenë të

deleguar në Kolegjin Zgjedhor, duhet ta përfitojnë këtë përparësi në bazë të ligjit. Jo vetëm kaq, por meqenëse kjo dispozitë është propozuar (i gjithë neni) bashkë me pikat e tjera, për t'i siguruar një mbrojtje më të madhe gjyqtarëve që punojnë në Kolegjin Zgjedhor dhe për t'i siguruar një përparësi në karrierë, në ngritjen e tyre në përgjithësi. Vetë termi i zgjedhur “delegim” është lidhur me delegimin në skemën e delegimit që bëjmë ne në Këshill, për këtë shkak edhe referimi në ligjin “Për statusin” është përcaktuar jo vetëm tek “lëvizja paralele” por edhe tek neni 48, pika 9, që është parashikuar qartë që përvoja në pozicionet e komanduara, germa a/i “si magjistrat në skemën e delegimit”, pra nënkuptohet që delegim konsiderohet edhe ai i Kolegjit Zgjedhor, do të konsiderohet përparësi në emërimet/në ngritjet në përgjithësi të gjyqtarëve.

Për këtë shkak ndaj mendimin që kjo duhet të konsiderohet përparësi dhe duhet të ketë renditjen më të...

Naureda Llagami: Faleminderit!

Po, Alban!

Alban Toro: Atëherë, se më duket e deformati edhe si skemë kolegia. Nuk bëhet fjalë tek 48-ta të përfshihet delegimi sipas Kolegjit Zgjedhor por është skema e delegimit, që është krejt ndryshe, është skemë vullnetare. Gjyqtarit i prishim rehatinë, ia heqim zyrën dhe e bëjmë me zyrë të lëvizshme dhe fluturon sa andej këndeje në funksion... Ta mbaroj. Nuk është delegim i skemës së delegimit, se ka një formalitet: Betohet për së dyti; ka një lëndë të caktuar; është i detyrueshëm. Kurse ky është vullnetar, është vullnetar dhe i prishet rehati; e çojmë nga zyra në zyrë dhe për këtë gjë ligji ka dhënë prioritet. Me këtë interpretimin e zgjeruar duhet t'i jepni prioritet edhe ish-anëtarit të KLD-së nesër kur të vijë të konkurrojë këtu, ose mos e dëgjoj të thoni “jo, nuk e ka përparësi këtë pjesë”. Me siguri, kur të konkurrojë, edhe një ish-anëtar i KLD-së “do të thotë: “E keni zgjeruar thesin; e keni zgjeruar komandimin; e keni zgjeruar delegimin; tani dua edhe unë që jam anëtar i ish-KLD-së.”

Ligji rregullon marrëdhënien juridike në kohën kur krijohet.

Naureda Llagami: Atëherë, nëse nuk kemi më diskutime...

Po, zonja Shehu!

Marçela Shehu: Faleminderit!

Unë në fakt do doja që ky diskutim të ishte bërë kohë më përpara, pra jo sot kur kemi dy emra konkretë, dy kandidatë. Unë nuk ndjem komode në fakt që ky diskutim në lidhje me një standard që duhet të ishte vendosur pak më përpara, të bëhet pikërisht sot kur kemi propozime dhe emra konkretë sepse kam përshtypjen që jo vetëm unë por të gjithë anëtarët e Këshillit kanë konsiderata shumë të larta për të dy kandidatët, si për sa i përket aftësive profesionale, ashtu edhe për sa i përket integritetit të tyre moral.

Në lidhje me diskutimin ose qenia anëtar i Kolegjit Zgjedhor do të konsiderohet apo jo vlerë e shtuar, unë dakordësohem me atë që thanë kolegët duke thënë që po. Në vitin 2020, me ndryshimet që iu bënë ligjit “Për Kodin Zgjedhor”, ligji parashikoi që qenia anëtar i Kolegjit Zgjedhor përbën vlerë të shtuar. Fakti që nuk është parashikuar në ligjin tonë “Për statusin”, për mua nuk është pengesë për shkak që ky moment të mos konsiderohet si vlerë e shtuar për ata kandidatë që kanë apo e kanë pasur këtë përvojë profesionale. Nuk dakordësohem me diskutimin që u bë që qenia anëtar i Kolegjit Zgjedhor është njësoj me delegimin. Jo! – siç tha edhe zonja Ukperaj dhe zoti Toro, janë dy institute të ndryshme. Skema e delegimit rregullohet dhe funksionon veçmas. Qenia anëtar i Kolegjit Zgjedhor rregullohet dhe funksionon veçmas dhe nuk ka lidhje me delegimin. Me këtë pjesën dakordësohem.

Tani diskutimi për mua është, ai që ngriti edhe zoti Toro, a ka apo jo fuqi prapavepruese ligji i 2020-ës i cili i njohu si vlerë të shtuar përvojën profesionale anëtarëve të Kolegjit Zgjedhor. Këtë diskutim, sikurse e tha edhe zonja Ukperaj, ne e kemi ngritur edhe më përpara, në momentin kur ne diskutuam dhe miratuam rregulloren për procedurat e ngritjes në detyrë. Në atë rregullore ne përfshimë dhe parashikuam në përkufizimet përkatëse që rregullonin pikërisht komandimin, që po, komandimi është vlerë e shtuar jo vetëm për gjyqtarët të cilët e kanë këtë komandim pas hyrjes në fuqi të ligjit “Për statusin” por edhe ata gjyqtarë që e kanë pasur këtë përvojë më përpara hyrjes në fuqi të ligjit “Për statusin”.

Sikurse u relatua me të drejtë, ai vendim ka pasur diskutime, kundërshti dhe me sa mbaj mend gjashtë anëtarë kanë votuar pro, pesë anëtarë kanë votuar kundër, pra ka qenë

një temë dhe një diskutim i rëndësishëm juridik, për sa kohë vazhdon bëhet edhe sot. Por ama ky diskutim u bë dhe më pas Këshilli mori të mirëqenë vullnetin e Këshillit dhe në vijim, në procedurat e ngritjes në detyrë, të gjithë kandidatëve ia konsideroi bonus.

Unë do kisha vlerësuar dhe do kisha gjetur me të drejtë që ky diskutim (prandaj e nisa fjalën time me këtë “dëshirë”) të ishte bërë më përpara. Pra kishte vend që ajo rregullorja jonë e procedurave të ngritjes në detyrë të përditësohej, të përfshihej edhe aty një parashikim i tillë? Pra, çfarë është të qenët anëtar i Kolegjit Zgjedhor? “Të qenët anëtar i Kolegjit Zgjedhor ...”, dhe jepnim përkufizimin përkatës duke parashikuar edhe efektet prapavepruese siç bëhmë në rastin e komandimit. Sepse nëse nuk do kishim atë rregullore në fuqi në rastin e komandimit nuk besoj se ne do t’i kishim dhënë vlerë prapavepruese ligjit. Ligji nuk ka fuqi prapavepruese. Ky është parimi dhe rregulli i përgjithshëm. Kjo nuk është bërë, nuk është vlerësuar që ajo rregullore të përditësohej apo të rishikohej.

Përpara se unë të shpreh votën time për një nga projekt-aktet që ka paraqitur Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, unë do doja që fillimisht Këshilli të votonte standardin sepse sot janë këta dy kandidatë, nesër do jenë kandidatë të tjerë. Të votojmë standardin. Pra qenia anëtar i Kolegjit Zgjedhor është vlerë e shtuar pas 2020-ës (para dhe pas 2020-ës)? Nëse Këshilli vlerëson që kjo gjë do ketë vlerë prapavepruese, atëherë unë do kaloj në votimin e projekt-aktit përkatës. Ky do të ishte mendimi dhe kërkesa ime. Pra të votojmë fillimisht standardin.

Naureda Llagami: Atëherë, këtu kemi ardhur me akt konkret në fakt dhe ne gjithë standardet i kemi vlerësuar sipas rastit. Edhe në diskutimet e tjera që kemi pasur kemi thënë që duhet të vijë çështja që ne ta vlerësojmë si standard dhe unë besoj që me këtë çështje dhe me qëndrimet që gjithsecili prej nesh dhe ndoshta do reflektohet edhe tek arsyetimi, besoj se do krijojmë një standard edhe për këtë gjë. Pse jo, e reflektojmë edhe në rregullore. Por ne nuk mundet tashmë që të themi që do krijojmë... sepse çështja është standard për të gjithë ne, siç kanë qenë çështjet e tjera standard ku nuk kemi pas më diskutime, dhe ky është një standard që ne e ndajmë përfundimisht interpretimin për sa i përket përparësisë në vlerësim për persona që janë angazhuar në Kolegjin Zgjedhor.

Kështu që unë besoj, me votimin dhe me argumentet që gjithsecili do japi në

votimin e tij, duke i shtuar vlerë edhe argumenteve që ka sjellë Komisioni, do jenë argumente shtesë, dhe nga gjithsecili prej nesh në një farë mënyre vendosim si standard të përgjithshëm për këtë çështje.

Marçela Shehu: Kur unë e bëra kërkesën për vendosjen e standardit, nuk besoj se e bëra kot dhe thashë që ne e vendosëm standardin për komandimin me atë rregullore. Nëse nuk do e kishim vendosur, nuk besoj se do konsiderohej vlerë e shtuar, kur ne kemi proceduar me ngritjet në detyrë, sepse ligji nuk ka fuqi prapavepruese.

Unë, pavarësisht se isha kundër me atë vendim të Këshillit, në të gjitha rastet e tjera pastaj kam respektuar vullnetin dhe standardin që vendosi Këshilli, që komandimi “po”, por e tha me atë vendim Këshilli, me atë vendim standard, që po, komandimi ka fuqi prapavepruese. Të njëjtën gjë po kërkoj edhe në këtë rast. Para se të votoj për vendimin përkatës, unë kërkoj që të vendoset standardi dhe nuk e kuptoj ku është problemi apo shqetësimi për këtë gjënë. Mund të ishte bërë rishikimi i rregullores. Nuk kemi pse të miratojmë standardin tani dhe të bëjmë rishikimin e rregullores. Nuk po kërkoj të shtyhet që të përmirësohet rregullorja sepse po me vendim Këshilli u miratua ajo rregullore dhe po me vendim Këshilli do vendoset edhe standardi sot. Këtë po kërkoj.

Naureda Llagami: Mirë! Ky ishte opinionimi im.

Në qoftë se ju e vlerësoni kështu, atëherë po hedh në votim çështjen a duhet të vlerësojmë fillimisht një standard dhe më pas të vlerësojmë çështjen konkrete.

Ilir Rusi: Kundër.

Irena Plaku: Unë vlerësoj që duhet të shprehemi drejtpërdrejt për çështjen dhe më pas nëpërmjet çështjes interpretojmë dispozitat e ligjit përkatës. Kështu që ne kur të vendosim të kemi edhe interpretimin përkatës dhe nuk kemi pse të vendosim një ligj apo një rregullore. Kështu që jam për të vendosur për çështjen.

Dritan Hallunaj: Duke qenë para faktit se këtu nuk po ndryshojmë rregulloren nga rregullorja personalisht, por unë i qëndroj asaj që rregullorja që kam miratuar (kam qenë anëtar) dhe të gjitha këto që deklaroam dhe përcjellë në relacion janë rrjedhojë e asaj rregulloreje, dhe unë jam kundër.

Ridvan Hado: Unë e thashë mendimin tim. Me një fjalë, që ligji s'ka fuqi prapavepruese.

Naureda Llagami: A mendon që fillimisht të vendosim një standard për interpretimin apo ta diskutojmë interpretimin tek çështja?

Ridvan Hado: Unë e thashë mendimin tim. Rasti konkret zgjidh edhe standardin dhe këtu mbaron diskutimi. Faleminderit!

Alban Toro: Jam dakord, sepse përmes një akti individual nuk mund të prodhohet një akt normativ.

Fatmira Luli: Jam kundra, sepse rendi i ditës është për një akt individual dhe nuk kemi ndryshim propozime për një akt normativ. Kjo mund të bëhet nëse kemi propozime për ndryshimin e aktit dhe mund ta pasqyrojmë më vonë me një propozim nga KZHK-ja për ndryshimin e rregullores.

Marçela Shehu: Jam dakord.

Yllka Rupa: Kundër, sepse unë mendoj që nuk është çështje që lidhet me standardin, por çështje interpretimi të ligjit. Edhe interpretimi në këndvështrimin e një marrëdhënieje juridike punësimi është shumë i thjeshtë në këtë. Pra nuk shoh një diskutim që edhe lidhur me interpretimin e ligjit ka dyshime. Kundër.

Brikena Ukperaj: Kundër, për arsye sepse në vlerësimin tim, e parashikojmë/nuk e parashikojmë në rregullore, karriera e gjyqtarit është një. Çdo kontribut në karrierën e gjyqtarit vlerësohet dhe nuk do të thotë që meqenëse e parashikuam në tek rregullorja paska efekt prapaveprues. Në mënyrën se si unë e interpretoj ligjin, ku ligji i jep përparësi çdo kontributi të gjyqtarit, ky kontribut shtrihet në të gjithë karrierën e tij dhe jo vetëm nga momenti i hyrjes së ligjit në fuqi. Nga ana tjetër i mëshoj edhe faktit që në këtë rast nuk jemi me interpretimin me analogji por jemi me interpretim sistematik të dispozitave.

Klodian Kurushi: Në lidhje me këtë propozim po bëj një koment dhe pastaj do jap mendimin tim për të vendosur sot standardin. Siç e kuptoj unë, vendosja e standardit në lidhje me vlerën e shtuar ose jo që mund të ketë anëtari i Kolegjit Zgjedhor lidhet me miratimin e një rregulli shtesë që ne duhet ta përditësojmë rregulloren nr. 70/2020 dhe që ta bëjmë këtë duhet edhe një punë paraprake. Komisioni të merret, të bëjë verifikimet përkatëse; pra të marrim njëherë një vendim që duhet të vendosim një standard; t'ia ngarkojmë punën komisionit konkret; komisioni konkret të bëjë verifikimet; të paraqesë

projektpropozimin dhe pastaj të miratojmë standardin me vendim. Nëse e bëjmë në këtë pjesë sot, do pezullojmë të gjithë këtë procedurën tjetër që kemi në proces.

Unë kështu e kuptoj. Kur thua “hajde të vendosim standardin”, standardin do ta vendosim mbi bazën e një procedure, siç kemi vendosur standardet e parashikuara në rregulloren nr. 70/2020. Kjo është e para për procedurë. Pra duhet njëherë të përditësojmë rregulloren. A do duhet t’i japim një përgjigje/vlerë të shtuar edhe anëtarit të Kolegjit Zgjedhor apo jo (me efekte prapavepruese siç kemi bërë tek komandimi)? Dhe kjo duhet të vendoset në rregullore. Për t’u vendosur në rregullore duhet një punë paraprake dhe një propozim që ta miratojmë pastaj si Këshill, dhe aty themi që kemi vendosur standardin. – Kjo është pjesa e parë e diskutimit.

Pjesa e dytë e diskutimit. Me keqardhje po them që ne po vëmë në dyshim praktikën tonë. Deri tani ne kemi emëruar gjyqtarë në Gjykatë të Lartë dhe në gjykatë të apelit me këto standarde të cilat sot unë i shoh që nuk dakordësohemi të gjithë, ama i kemi votuar të gjithë, i kemi votuar të gjithë në një vlerë tjetër të shtuar siç është komandimi, por nuk duam të dakordësohemi sot me një vlerë tjetër të shtuar që thotë ligji që është delegimi në Kolegji Zgjedhor. E thamë dhe e kemi të implementuar edhe në relacionin tonë. Vetë ligjet, si Kodi Zgjedhor, si ligji “Për statusin”, nuk kanë bërë diferencime midis komandimit dhe kontributit që jep gjyqtari në skemën e komandimit dhe kontributit që jep gjyqtari si vlerë e shtuar si qenie anëtar i Kolegjit Zgjedhor. Ligji këto i ka quajtur vlera të shtuara dhe për komandimin e kemi qasje, jo qasje tamam, por kemi standard për të. Them po, i kemi dhënë vlerë me fuqi prapavepruese. Unë përmenda shembuj ku edhe vetë kam votuar.

Tani, në rastin e sotëm, themi jo, duhet të përcaktojmë një standard që unë po e kuptoj si standard të ndryshëm me propozim. Se s’po dakordësohemi dot me standardin e vendosur nga rregullorja 70/2020, por duam të ndryshojmë standardin.

Po mirë, Ok, po e nisim si procedurë dhe iniciativë një gjë të tillë, po me ato çfarë kemi bërë deri tani? Po me ato gjyqtarë që i kemi emëruar deri tani, çfarë do ndodhi? A krijojmë ndonjë pasiguri juridike apo jo? Në raport edhe me kolegët tani që janë edhe kandidatë. T’i themi: - “Kemi gabuar deri tani. Na falni!”

Dhe së fundmi, pastaj të bëj votimin.

Ju dëgjova! Se jam edhe unë relatori i kësaj çështjes.

Së fundmi, unë ndjehem emocionalisht jo mirë kur na vihen përballë dy kandidatë që për mendimin tim kanë vlera shumë të mira, të jashtëzakonshme, si gjyqtarë, dhe unë i vlerësoj maksimalisht të dy kandidatët, dhe do ndjej keqardhjen që njëri nga ata fatkeqësisht, në këtë procedurë konkurrimi, të ashpër, të keq, do shmangi tjetrin. Por në këtë pikë unë nuk përjashtoj dot praktikën që ka ndjekur Këshilli si dhe praktikën që kam ndjekur unë personalisht në këtë Këshill kur kam votuar për kandidatë të tjerë që kanë shkuar në Gjykatën e Lartë. E di kur mund të dakordësohesha – se ne e kemi thënë edhe në diskutim në Këshill – në një rast kur ky ligj nuk duhet të ketë efekte prapavepruese. Nëse në ndryshimet e reja që ka pësuar Kodi Zgjedhor, anëtarit të Kolegjit Zgjedhor do t'i ishin dhënë funksione të reja shtesë dhe detyrime të ndryshme nga anëtarët që kanë ekzistuar përpara hyrjes në fuqi të ndryshimeve të reja ligjore. Në këtë pikë unë do thosha prit, siç e tha edhe zonja Ukperaj, ndodhemi përpara një marrëdhënieje të re. Pra nëse ai përpara ndryshimeve kur e ka pësuar si bonus, e ka marrë si bonus dhe vlerë të shtuar qenien anëtar, por përpara ndryshimeve kishte vetëm të drejta dhe pas ndryshimeve kur i është atashuar bonusi, i kufizohet veprimtaria e tij për shkak të detyrimeve që mund t'i ketë shtuar ligji si anëtar i Kolegjit Zgjedhor dhe për shkak të këtyre detyrimeve e kompensoi edhe me një vlerë, atëherë do thosha prit, nuk janë të njëjtat funksione të anëtarit të Kolegjit Zgjedhor si para ndryshimeve dhe pas ndryshimeve. Por marrëdhënia (se e kemi analizuar), ka qenë e njëjtë që nga 2008 deri në 2021, e pandryshuar në të drejta dhe detyrime për anëtarin e Kolegjit Zgjedhor dhe është thënë në relacion mënyra e përzgjedhjes, subjekti i përzgjedhjes, mandati, detyra që do kryente, detyrimet e tjera të shtetit karshi atij dhe anëtarit karshi shtetit; janë të njëjtat, të pandryshueshme. Në këtë pikë nuk kemi pse të bëjmë diferencime (e kemi thënë). Nëse ligji i ka bërë diferencimet me ndryshimet e reja, do dakordësoheshim e do thoshim prit, se këtu ka një rrethanë të re që vlen për t'u diskutuar.

Ndodhur në këto kushte, unë nuk jam dakord me këtë propozim që bëhet sot nga zonja Marçela Shehu. Faleminderit!

Naureda Llagami: Edhe unë nuk jam dakord.

(Nuk miratohet.)

Naureda Llagami: Përpara se të kalojmë në votimin e projekt-aktit, fjalën e ka

sërish zoti Toro.

Alban Toro: Atëherë, për të kontestuar kolegun që foli, i cili pretendoi meqenëse në rregulloren tonë të cilën e kemi konvertuar me ligj, ku përvojat në pozicionet e komanduara kemi konsideruar, jo vetëm ato që ka parashikuar ligji por edhe ato përpara se ligji të hynte në fuqi, dhe në këtë kuadër neve nuk po japim të njëjtën gjë edhe instituteve të tjera të cilat janë krijuar më pas edhe se vetë ky ligj, mund të them fare thjesht që ne kemi zbatuar një akt normativ i cili në rastin konkret ka pas fuqi të detyrueshëm dhe ndoshta mund të bëj “mea culpa” në këtë rast që s’e kam kontestuar në gjykatë sepse e konsideroj edhe sot të kundërligjshëm, por gjithsesi për mua është i detyrueshëm për t’u zbatuar dhe në këtë cilësi kam votuar edhe personat që kanë pasur komandime në periudha para se të hynte ligji në fuqi. Nuk po përmend emra, por kam respektuar këtë urdhërim.

Tani, të respektoj urdhërimin e kujt për të përfshirë këtu edhe Kolegjin Zgjedhor apo ish-anëtarin e KLD-së që do vijë nesër. Kjo është.

Naureda Llagami: Atëherë, pas gjithë këtyre diskutimeve, mendoj që ka ardhur momenti që ta hedhim në votim projekt-aktin e parë të propozuar nga Komisioni, i cili ka renditjen e tillë që në vend të parë është znj. {...}, në vend të dytë është z. {...}, në vend të tretë është znj. {...}, për të gjithë argumentet që u thanë në këtë mbledhje.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Kundër, për sa i përket vendit të dytë, sipas shpjegimeve që dhashë gjatë diskutimit. Faleminderit!

Alban Toro: Kundër.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Unë jam kundër pjesës që ligji ka fuqi prapavepruese dhe që ne t’i japim fuqi prapavepruese një vlere që nuk ka qenë e konsideruar përpara vitit 2020. Por ngas të gjitha diskutimet që unë kuptova këtu nga Këshilli, pavarësisht se nuk u votua standardi që unë kërkova me një vendim të Këshillit lidhur me këtë moment, por nga të

gjithë kundërshtitë, deklaratimet dhe qëndrimet, kuptova që Këshilli do t'i trajtojë njësoj si komandimin ashtu edhe të qenët anëtar i Kolegjit Zgjedhor, më bën të dyshoj faktikisht. Gjithsesi unë vazhdoj të jem kundër.

Yllka Rupa: Pro. (*Vota e zonjës Rupa nuk dëgjohet në audio, por e kontaktuar nëpërmjet e-mailit ka konfirmuar (citor): "pro". Për efekt të procesverbalit e-maili i konfirmimit të votës i bashkëlidhet procesverbalit të siglosur.*)

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e renditjes së gjyqtarëve që kandidojnë për t'u emëruar në Gjykatën e Lartë, në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. 537, datë 17.11.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

1) Znj. {...};

2) Z. {...};

3) Znj. {...}.

2. Propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë, në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. 537, datë 17.11.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të kandidatit z. {...}.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit iu njoftohet kandidatëve znj. {...}, znj. {...} dhe z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar.

4. Kundër vendimit mund të bëhet ankim nga çdo kandidat, në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.

Ky vendim botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 14.06.2023)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

2.1 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.

2.2 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.

2.3 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.

2.4 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.

2.5 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.

2.6 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:14 dhe mbaroi në orën 15:30.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------|--------------------------|
| <i>1. Naureda Llagami</i> | <i>(kryetare)</i> |
| <i>2. Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>3. Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>4. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>5. Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>6. Dritan Hallunaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>7. Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>8. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>9. Marçela Shehu</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>10. Brikena Ukperaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>11. Yllka Rupa</i> | <i>(anëtare)</i> |

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashë.*
- 3. Luan Dibra, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani dhe Vjollca Kola Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
- 5. Mary Kate Butterfield dhe Blerina Fani, përfaqësues të OPDAT-it.*
- 6. Valbona Bala, eksperte (EWMI-INL).*
- 7. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).
 - 2.1 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.
 - 2.2 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.
 - 2.3 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të

Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.

2.4 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.

2.5 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.

2.6 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti i radhës që ka të bëjë me hapjen e procedurave të lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë për tre pozicione në fushën e të drejtës civile dhe në Gjykatën e Shkallës së Parë Durrës për tre pozicione në fushën e të drejtës civile.

Për më shumë detaje fjalën ia jap relatorit zotit Toro.

Alban Toro: Faleminderit!

Prej kohësh në optikën e Këshillit ka qenë gjendja e nderë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë e cila ka një ngarkesë katastrofike dhe në këtë kuadër ka bërë disa përpjekje për të plotësuar vakancat e shumta që ka në atë gjykatë. Një nga këto përpjekje është edhe rasti në fjalë.

Mund të citoj që aktualisht Gjykata e Tiranës në strukturën organizative ka 80 gjyqtarë; Efektivisht në detyrë janë 43 gjyqtarë. Ndërkohë që kjo gjykatë aktualisht ka 43 pozicione të lira, nga të cilat 29 të përkohshme dhe 14 të përhershme (ndërkohë që paraprakisht janë hapur edhe 10 pozicione të lira në fushën e të drejtës civile në procedurën e lëvizjes paralele e cila po vijon dhe priten vlerësimet), nisur nga kjo, pranë kësaj gjykate janë 4 pozicione të lira të përhershme (ku përfshihet dhe ai i kryetarit). Aktualisht çështjet pranë kësaj gjykate, ngarkesa e kësaj gjykate është dikur tek 22 185 çështje.

Të njëjtin problem ka edhe Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës e cila si strukturë organizative është 23, efektivisht është pothuajse gjysma (12). Edhe kjo gjykatë ka gjithsej 13 pozicione të lira, nga të cilat 6 të përkohshme dhe 7 të përhershme, (ku edhe për këtë gjykatë Këshilli më parë ka hapur 4

pozicione të lira në fushën e të drejtës civile në procedurën e lëvizjes paralele), dhe nisur nga kjo, pranë kësaj gjykate janë tre pozicione të lira të përhershme. Edhe në këtë gjykatë ka një numër të konsiderueshëm çështjesh në shqyrtim, janë 4 174.

Kështu që, nga ana e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës është parashikuar/është trajtuar, si i vetmi instrument i cili mund ta shërojë plotësimin e pozicioneve të përhershme, nëpërmjet hapjes së procedurës së lëvizjes paralele, e cila rregullohet nga neni 43 i ligjit “Për statusin”. Qëllimi i këtij neni është të garantojë zhvillimin e procesit të lëvizjes paralele, si një nga format e transferimit të magjistratit, duke parashikuar rregulla që adresojnë si nevojat e sistemit të drejtësisë, ashtu edhe të drejtën e magjistratit për ecurinë në karrierë. Bazuar në parimet e parashikuara në nenin 42, ligjvënësi ka synuar që nëpërmjet rregullave kryesisht procedurale në nenin 43, të garantojë qartësi dhe parashikueshmëri për transferimin e magjistratit në procedurën e lëvizjes paralele, si një nga mjetet standarde të lëvizjes së gjyqtarëve brenda të njëjtit nivel.

Këshilli i Lartë Gjyqësor është i detyruar të vlerësojë, periodikisht ose rast pas rasti, nevojën për plotësimin e vendeve të lira në gjykata duke respektuar kushtet dhe parimet të parashikuara në nenin 42 lidhur me transferimin e magjistratit si dhe të rregullave të hollësishme që parashikon neni 43 për lëvizjen paralele. Në zbatim të nenit 42, pika 3 dhe 4 të Ligjit nr.96/2016, Këshilli është i detyruar të organizojë, të paktën çdo tre muaj, procedurën e lëvizjes paralele për çdo pozicion që: a) është i lirë; b) pritet të bëhet i lirë brenda tre muajve. Aktualisht ky parashikim duket që ka gjetur edhe mbështetjen e shumicës së anëtarëve për të cilët tashme problemi i mbylljes së procedurave të vlerësimit dhe i ngarkesës që krijohet për burimet tona të kufizuara njerëzore konsiderohet superant. Në zbatim të kësaj procedure magjistratët do t’i nënshtrohen së pari renditjes së preferencës, parashikuar nga neni 42, pika 3 e ligjit “Për statusin” dhe rregullave lejuese e ndaluese që parashikohen në nenin 43, me qëllim plotësimin e vendeve të lira sipas një renditje të caktuar që respekton parimet e sanksionuara në nenin 42.

Qëllimi i nenit 42 është të garantojë se procesi i transferimit të përkohshëm ose të përhershëm të magjistratit, në pozicione të ndryshme brenda të njëjtit nivel ose të barasvlershëm me të, të bëhet jo vetëm sipas nevojave të sistemit të drejtësisë, por edhe në respektim të funksionit të magjistratit. Duke vendosur disa parime bazë, mbi të cilat

kryhet transferimi, ligjëvënësi synon së pari të disiplinojë këshillat në vendimmarrjen që lidhen me transferimin në pozicione të përhershme ose të përkohshme të magjistratëve sipas rregullave të parashikuara specifikisht dhe procedurave respektive. Së dyti, ai synon të ofrojë siguri, qartësi dhe para shikueshmëri për magjistratin, i cili mund t'i nënshtrohet lëvizjes në pozicion.

Në pikën 3 janë përcaktuar kategoria e gjyqtareve për të cilët Këshilli ka detyrimin t'i përjashtojë nga zbatimi i procedurës së lëvizjes paralele duke i caktuar në një nga pozicionet e përhershme. Rrethanat dhe kategoria e magjistratëve që caktohen në një pozicion të lirë janë si më poshtë:

a) nga magjistrati që ka të drejtë të caktohet në nivel apeli;

b) nga magjistrati që transferohet për shkak të papajtueshmërisë ambientale ose për shkak të ndryshimeve në strukturën administrative ose kompetencën tokësore të gjykatave ose prokurorive.

Në pikat 3 dhe 4 jepen kategoritë e magjistratëve, sipas radhës, që kanë të drejtë të transferohen në pozicionet e përkohshme dhe të përhershme. Konkretisht, radhën për plotësimin e pozicioneve të përhershme e kanë:

a) magjistrati që ka të drejtë të caktohet në nivel apeli;

b) magjistrati që transferohet për shkak të papajtueshmërisë ambientale ose për shkak të ndryshimit të strukturës administrative;

c) magjistrati që transferohet sipas lëvizjes paralele;

ç) magjistrati që ka të drejtën e ngritjes në detyrë.

Për plotësimin e pozicioneve të lira të përhershme Këshilli është i detyruar të respektojë radhën sipas shkronjave a); b); c) dhe ç). Në kushtet kur Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Durrës, janë gjykata të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, procedura e ngritjes në detyrë në këto gjykata nuk mund të aplikohet. Pozicionet e lira të përhershme në këto gjykata mund të plotësohen si rregull vetëm nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele në rast se nuk ka magjistratë që duhet të transferohen pranë këtyre gjykatave sipas parashikimeve të shkronjave a) dhe b). Pas verifikimeve të kryera, ka rezultuar se aktualisht, nuk ka nevoja emergjente të gjyqtareve për t'u caktuar në përputhje me këtë dispozitë.

Pas kësaj faze, Komisioni, duke marrë në konsideratë situatën e pasqyruar më lart,

në të cilën ndodhen sot, Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Durrës, do t'i propozojë Këshillit të shpallë hapjen e procedurës së lëvizjes paralele për 3 pozicione të lira të përhershme, në fushën e së drejtës civile, marrë në konsideratë ngarkesën e konsiderueshme të dhomës civile në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe 3 pozicione të lira të përhershme, në fushën e së drejtës civile, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, në përputhje me nenin 43 e vijues të ligjit “Për statusin” dhe vendimin nr.320, datë 17.09.2020.

Ky propozim bazohet nisur nga ngarkesa tepër e lartë e dhomës civile/lëndës civile, respektivisht 18 234 çështje civile në Tirane dhe 2 453 çështje civile në Durrës si edhe kohës së madhe mesatare për gjykimin e çështjeve civile e pasqyruar në raportin vjetor të vitit 2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, e cila është 261 ditë (mesatarja ligjore është 168 ditë) për gjykimin e çështjeve civile, dhe 87 ditë, (mesatarja ligjore është 98 ditë), për gjykimin e çështjeve penale në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ndërkohë që në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës rezulton të jetë 213 ditë për gjykimin e çështjeve civile dhe 119 ditë për gjykimin e çështjeve penale.

Më tej, Komisioni vlerëson se ngarkesa prej 22 160 çështjeve në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tirane dhe me 4 174 çështjeve Durrës, në kuptim të nenit 89 të Ligjit nr.115/2016 si edhe detyrimit të parashikuar në nenin 35 e në vijim të Ligjit nr.96/2016 për caktimin e 40 gjyqtarëve të rinj që pritet të mbarojnë Shkollën e Magjistraturës do të kërkojë finalizimin e procedurave të lëvizjes paralele sa më shpejt që të jetë e mundur e ndërlidhur kjo edhe me procesin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve që do të kandidojnë që nisur nga eksperiencia aktuale ka rezultuar e gjatë. Duke vlerësuar në përputhje me të dhënat statistikore se ngarkesa e dhomës civile në të dyja Gjykatat vijon të jetë relativisht tepër e madhe dhe në respekt të parimit “të një gjykimi brenda një afati të arsyeshëm”, do të sugjerohet hapja e pozicioneve vetëm në fushën civile.

Në të ardhmen, për të parandaluar mosrespektimin nga ana e Këshillave të Gjykatave, siç edhe ka ndodhur me disa të tilla, të fushës specifike ku gjyqtaret pas konkurrimit do të caktohen nga vendimmarrja e Këshillit në projektvendim, do të

parashikohet një pikë e veçantë që në kuptim të nenit 89 të ligjit 115/2016 të sanksionojë një detyrim të tillë që synon përmirësimin e ngarkesës së gjyqtarëve dhe produktivitetit të gjykatës.

Pra përfundimisht, nga ana e KZHK-së ju propozohet fillimi i procedurave për lëvizje paralele për 3 pozicione të lira të përhershme në fushën e së drejtës civile në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe për 3 pozicione të lira të përhershme në fushën e së drejtës civile në Gjykatën Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

Gjithashtu për këtë është përgatitur edhe projektvendimi ku në dispozitiv është parashikuar hapja e procedurës së lëvizjes paralele dhe shpallja e kërkesës për kandidatura; Afati i kandidimit ku është ruajtur standardi dyjavor dhe propozohet data 28, pra afati i kandidimit të jetë deri më datë 28.06.2023; Dokumentacioni që i bashkëlidhet kandidimit; Forma e procedurës së lëvizjes paralele; Dhe hyrja në fuqi e tij. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit zoti Toro!

Atëherë, po znj. Ukperaj!

Brikena Ukperaj: Faleminderit zonja Kryetare!

Kam një pyetje për relatorin.

Pse nga Komisioni në këtë rast është shmangur zbatimi i nenit 42, pika 3, germa “b” e ligjit “Për statusin”?

Alban Toro: Meqenëse përmende nenin 42, pika 3/b, është një dispozitë që ka disa parashikime dhe do ju lutem ta identifikoni cila nga këto fakte juridike duhen trajtuar?

Brikena Ukperaj: Në fakt unë prisja që të ishte detajuar në relacion, por relacioni është lënë shkarazi me një fjali, ku është thënë: “Pas verifikimeve të kryera, ka rezultuar se aktualisht, nuk ka nevoja emergjente të gjyqtarëve për t’u caktuar në përputhje me këtë dispozitë.” Prandaj ia bëra pyetjen relatorit, sepse nuk e gjej të sqaruar në relacion, se po ta kisha, nuk do ta kisha bërë pyetjen. Dhe pyetja ime është: Pse në këtë moment

ndryshohet standardi i Këshillit dhe nuk iu propozohen vendet vakante gjyqtarëve që kemi mbi struktura? Ne kemi mbajtur një qëndrim, që sa herë kemi propozuar mekanizma për zgjidhjen e situatës në Tiranë dhe në Durrës, qëndrimi i Këshillit ka qenë i tillë që, madje e kemi bërë edhe publikisht, fillimisht kanë të drejtën e zgjedhjes gjyqtarët që janë mbi struktura organizative të gjykatave. Ne para këtij relacioni kemi pasur një relacion tjetër nga ana e Komisionit, që na janë evidentuar disa gjyqtarë të tjerë që janë mbi struktura dhe janë edhe sot mbi struktura. Pse në këtë rast nuk ia u ofrojmë vendet atyre?

Alban Toro: Pra siç mund ta keni konstatuar, është përdorur terminologjia “emergjente”, që nënkupton që për momentin Komisioni i Zhvillimit të Karrierës nuk ka proceduar në plotësimin e këtyre vendeve vakante me personelin gjyqësor i cili ndodhet jashtë strukturave (të përmendura në atë relacionin që ju cituat), sepse aktualisht nuk ka një emergjencë për ta kryer këtë, pasi ata gjyqtarë të cilët aktualisht janë jashtë strukturës në një gjykatë të caktuar, përfitojnë pagë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku janë komanduar. Ekzistenca e pagës, pra marrja e pagës pranë kësaj gjykate mundëson dhe largon emergjencën nga ky trajtim. Gjithsesi do të mbetet në fokusin e KZHK-së në të ardhmen, që vendet e lira që do të trajtohen apo që do të rezultojnë të tilla pranë kësaj gjykate apo në ndonjë gjykatë tjetër, të plotësohen menjëherë nëse do të konstatohet ndonjë emergjencë e tillë, për t’i plotësuar ato vakanca me këtë personel gjyqësor.

Nëse ke ndonjë emër konkret pastaj, mund edhe ta elaborojmë.

Brikena Ukperaj: Emrin konkret e keni thënë ju në relacion. Nuk e kam unë emrin konkret.

Atëherë, Kryetare, për të zbatuar të njëjtin standard si në rastin kur ne transferuam zonjën Shehu, zonjën Hoxha dhe zonjën Çabej, për të mbajtur të njëjtin standard që ne këto vende duhet t’ia u ofrojmë gjyqtarëve që janë mbi struktura, edhe në atë kohë nuk kishte ndonjë emergjencë të madhe, por ishte detyrim i ligjit, sepse gjyqtarët ishin të gjithë në pozicione të komanduara dhe paguheshin nga dikush tjetër, mendoj që para se ne të shpallim procedurat e lëvizjeve paralele, ne këto vakanca duhet t’ua ofrojmë gjyqtarëve që kemi sot mbi struktura.

Me sa pashë nga relacioni, këto janë vakancat e fundit, pra Tirana ka katër, shpallen tre; Durrësi ka tre, shpallen të tria. Nuk ka në këtë moment, të paktën nga përmbajtja e relacionit, vakanca të tjera.

Lidhur me gjyqtarët që janë mbi struktura, në relacionin e mëparshëm që na ka sjellë po Komisioni i Zhvillimit të Karrierës “Mbi gjendjen e faktit dhe zbatimin e mekanizmave ligjorë për gjyqtarët që rezultojnë mbi organikë pas implementimit të hartës së re gjyqësore në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Berat, Gjirokastrë dhe Shkodër, janë ose duken të individualizuar gjyqtarët që janë mbi struktura. I referohem Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat: mbi strukturë aktualisht janë gjyqtarët {...} dhe {...} {...}. Pse janë mbi strukturë? Nga përmbajtja e relacionit, unë për këtë gjë kam votuar, janë mbi strukturë, nuk i transferuam në atë moment për arsye sepse nuk ishte emergjencë për pagën, por kur bëhet fjalë për lëvizjen paralele, pa dyshim vlerësoj që për të respektuar standardin duhet t’ua ofrojmë vendin vakant këtyre dy gjyqtareve sepse ne edhe më parë, kur transferuam gjyqtarët, gjyqtarë jashtë strukture konsideruam ata gjyqtarë që ishin të komanduar në institucione të tjera dhe nuk ishin gjyqtarë efektivë në atë gjykatë (nuk iu referuam vjetërsisë në punë në atë gjykatë). Për këtë arsye mendoj që zonjës {...} dhe zonjës {...} duhet t’i ofrohen pozicione të lira në Tiranë dhe Durrës me qëllim që ato të kenë një pozicion të caktuar në mënyrë të përhershme në një gjykatë sepse e kemi detyrim para se të hapim procedurën e lëvizjes paralele.

Lidhur me Gjykatën e Shkodrës është zgjidhur situata.

Lidhur me Gjykatën e Gjirokastrës, gjyqtarja që ndodhet në të njëjtat kushte e cila rezulton që të jetë e komanduar dhe jashtë strukture, është gjyqtarja {...} (referuar informacionit të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës). Prandaj unë propozoj për Këshillin që të fillojnë procedurat e transferimit të këtyre tre gjyqtarëve në një nga pozicionet e lira në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Durrës; t’ju lihet afat që të zgjedhin pozicionin dhe mbasi ato të zgjedhin, të shohim cilat janë pozicionet që ne shpallim për lëvizje paralele.

Këto janë mbi strukturë. Ky është mekanizmi që ke sjellë Klodi dhe kam parë dhe vakancat. S’ka asnjë para kësaj.

Alban Toro: Të bëj një sqarim të vogël?

Po t'i referohesh pozicioneve/vakancave tek Gjykata e Tiranës, ne kemi hapur tre pozicione të lëvizjes paralele dhe kemi lënë një valvul shfryrjeje. Mos harrojmë se në Durrës aktualisht do marrim në shqyrtim një pozicion i cili me gjasa do të bëhet i përhershëm, sepse një gjyqtar del në pension (ka dhënë dorëheqjen). Pra akoma kemi pozicione të tilla dhe akoma Tirana do të ketë nevojë edhe në të ardhmen për hapje të procedurave të lëvizjes paralele, sepse një pjesë e gjyqtarëve do të synojnë me të drejtë të konkurrojnë në pozicionet që kemi hapur për këtë shkak në apel dhe në këto kushte do të krijohen prapë vakanca të tjera për të cilat në momentin që do të verifikohet një rrethanë emergjente, këta gjyqtarë menjëherë do të pozicionohen pranë këtyre gjykatave.

Ndërkohë, për zonjën Palloj, nuk e di pse vonohet vlerësimi, i cili duhet të kishte mbaruar. Me sa më kujtohet, kandidon e vetme në mos u gabofsha. Mbaroni vlerësimin, që vazhdimisht për këtë shkak pozicionet e lira të përhershme bllokohen, dhe i japim drejtim, e sistemojmë në mënyrë përfundimtare dhe të merituar pranë Gjykatës së Krimeve të Rënda.

Brikena Ukperaj: Zonja Kryetare, unë nuk doja të dilja me emra se kush ka një pozicion dhe kush s'ka një pozicion. Përmenda emrat e gjyqtarëve që janë mbi struktura. Thashë, mbi struktura, relacioni juaj na ka sjellë këta gjyqtarë.

Tani, sa për zonjën Palloj, që të marrësh një përgjigje, presim dy akte verifikimi nga ILD-ja (është për ngritje në detyrë në gjykatën e posaçme). Mund t'ia bësh pyetje ILD-së Alban, pse nuk i sjell aktet. Dy ankesa kanë mbetur ende të paverifikuara. Nuk mund ta mbyllim raportin pa ardhur dy ankesat.

Të lutem mos bëj debat me mua, se s'bëra debat me ty. Po të jap përgjigje për pyetjen që ngrite.

Lidhur me arsyen tjetër, që kur të krijohen vendet do t'ia japim këtyre, kur të krijohen vende të tjera, do t'i shpallim prapë për lëvizje paralele. Ligji dhe qëndrimi që ne kemi mbajtur është që pa sistemuar gjyqtarët mbi strukturë nuk mund të shkojmë në hapje procedurash të lëvizjes paralele. Tani nuk mund ta ndryshojmë sot dhe t'i themi "do t'jua japim më vonë juve", se duket sikur jemi selektiv në përzgjedhjen e disa gjyqtarëve dhe disave jo. Kemi përgjegjësi përpara gjyqtarëve, relacionin e kam parë,

pash edhe atë organikën e gjykatave. Unë po bazohem në propozimin tim mbi relacionin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës. Nuk kam bërë vetë ndonjë relacion tjetër. Këta i kemi të evidentuar mbi strukturë. Hapim procedurat. Nëse ka edhe të tjerë, Komisioni duhet ta përcjellë.

I vetmi pozicion që zoti Kurushi thotë është një gjyqtar i komanduar në Këshill, që është larguar nga sistemi me dorëheqje. Kështu që edhe ajo duhet menduar se si duhet sistemuar. Por këta tre gjyqtarë janë tre gjyqtarë që janë të evidentuar që janë mbi struktura dhe që patjetër që duhet të sistemohen.

Do ngrihen në detyrë, do lëvizin. Mbaron vendi, e hapim për lëvizje paralele. Por mendoj që duhet të kemi standard të njëjtë në trajtimin e gjyqtarëve.

Naureda Llagami: Faleminderit zonja Ukperaj!

Atëherë, kalojmë në votim propozimin e zonjës Ukperaj.

Brikena Ukperaj: Unë kam përgatitur edhe tre projekt-akte. “Për fillimin e procedurës së transferimit të gjyqtarës {...} {...} për shkak të suprimimit të pozicionit në gjykatën ku është caktuar në mënyrë të përhershme”; “Për fillimin e procedurës së transferimit të gjyqtarës Rudina Palloj...” dhe për gjyqtaren {...}.

Dritan Hallunaj: Atëherë, personalisht unë duhet të njihem me ato materiale se s’mund të votojmë sot atë që nuk di se për çfarë po votoj. Ne duhet të shohim organikat. Pasi të kemi parë organikat, të shohim sa janë mbi strukturë. Se unë nuk e kam, nuk e disponoj atë material sot këtu. Kështu që të shohim kush janë mbi organika. Të ulemi dhe të bëhet një relacion, edhe ta diskutojmë pastaj.

Jam plotësisht dakord që pa sistemuar këto që janë mbi organikë, s’bëhet ky veprim. Por të kemi një material përpara. Thuhen tre emra. Nuk i vë në dyshim që janë ato të tre. Mund të ketë edhe të tjerë. Të shohim organikat.

Brikena Ukperaj: Zoti Hallunaj, bazohem mbi një relacion që na ka ardhur së fundi nga ana juaj në rastin e zonjës {...}. Është relacion që e ka sjellë karriera, nuk është se e kam bërë unë verifikimin. Në relacionin tuaj janë evidentuar të gjitha këto.

Klodian Kurushi: Të sqarojmë.

Relacionin që e kemi bërë ne e kemi bërë vetëm në kuadrin e hartës, pa iu referuar gjyqtarëve të tjerë që janë mbi strukturë. Tani, mos ta marrim pjesërisht. Për shkak të hartës kemi marrë vetëm tre gjykata.

Kryetare më fal, është bërë mbi strukturë për shkak të hartës, pasojave që sillte harta, dhe kemi marrë vetëm tre gjykata.

Duhet ta shohim tablonë pak më gjerë.

Marçela Shehu: Zoti Hallunaj ka nevojë, edhe unë personalisht, dua të kem një panoramë të saktë të çdo gjykate kush është mbi strukturë.

Naureda Llagami: Marçela, ky është diskutim që duhet ta ketë Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, që sa herë sjell hapje vendesh – sepse kështu duhet ta veprojmë tani.

Marçela Shehu: Çfarë të bëjnë edhe këta, me gjithë atë ngarkesë.

Naureda Llagami: Të gjithë me ngarkesë jemi.

Të jemi këtu midis nesh, siç kemi bërë lëvizjet e tjera, se pastaj paragjykohe mi të gjithë. Sa herë hapim vendet duhet të shohim mbi strukturë. Meqë paska, hajde të zgjidhim këto mbi strukturë, pastaj kalojmë.

Marçela Shehu: Ishte një harresë. Nuk e di çfarë mund të jetë.

Naureda Llagami: Shumë bukur. Hajde e korrigjojmë. Prandaj jemi këtu.

Marçela Shehu: Por kjo nuk do të thotë që të përfitojmë nga një harresë.

Naureda Llagami: Absolutisht.

Marçela Shehu: Parimisht jam shumë dakord.

Siç e tha edhe zonja Brikena është situatë e ngjashme dhe që ka funksionuar deri tani në Këshill. Kështu që nuk dua që të diskriminohet asnjë gjyqtar, por në mesin e këtyre gjyqtarëve që përmendi, mund të jenë edhe 10 të tjerë. Kështu që ta kemi situatën të qartë, ta kemi tablonë e qartë të situatës në çdo gjykatë dhe pastaj të procedojmë më tej.

Brikena Ukperaj: Marçela, situatën e kishim shumë të qartë në momentin kur Komisioni i Karrierës na solli problematikat e hartës gjyqësore, dhe ishin të individualizuara si gjyqtarë mbi strukturë vetëm Gjyrokastër...

Marçela Shehu: Nuk e kemi urgjencën sot Brikena.

Brikena Ukperaj: Po sot po e diskutojmë. Kur ta themi?

Ne këtu jemi.

...Gjyrokastër (një), Shkodra (dy) (e kemi relacionin dhe janë të individualizuar gjyqtarët), ka qenë Berati tre dhe Lezha (katër) – Shkodra që i çuam në Lezhë. Nuk ka të tjerë.

Klodian Kurushi: Më fal një sekondë tani, që ta sqaroj pak situatën.

E para, neve kemi ngritur/evidentuar gjyqtarët mbi strukturë, në atë relacionin e freskët që ju i referoheni, vetëm gjykatave që suprimoheshin për shkak të efekteve të hartës.

Brikena Ukperaj: Berati nuk ishte suprimuar.

Klodian Kurushi: Po ishte marrë një vendim për Beratin paraprakisht. Nga një numër i caktuar, u reduktua numri, dhe kjo ishte po për efekt të hartës, sepse u çuan në Tiranë ato gjyqtarët. Kështu që edhe Berati ishte pjesë e efekteve të hartës. Mos thuaj që nuk ishte. Ishte.

Brikena Ukperaj: Ishte, por s' ishte suprimuar.

Klodian Kurushi: U suprimuan edhe dy vende në Berat.

Ky ishte relacioni i freskët.

Ndërkohë, ne nuk kemi marrë në atë relacion strukturën e të gjithë gjykatave dhe mundësinë ose probabilitetin e gjyqtarëve të tjerë, që mund të jenë mbi strukturë jashtë këtyre gjykatave që u afektuan për shkak të implementimit të hartës.

Brikena Ukperaj: Klodi, je kryetar i Komisionit të Karrierës. Të thuash nuk di se kush gjykatë ka sot mbi strukturë?! Tani çfarë të them?!

Klodian Kurushi: Patjetër!

Marçela Shehu: Unë nuk i di.

Brikena Ukperaj: Mund ta thotë Marçela. Po ti je kryetar i Komisionit të Karrierës. Thua që nuk di se kush gjyqtar është sot mbi strukturë?!

Klodian Kurushi: Patjetër! Në të gjithë republikën?

Duhet ta kem përpara, ta verifikoj njëherë.

Brikena Ukperaj: Po sigurisht, ti sot vjen me propozim për lëvizje paralele.

Klodian Kurushi: Po, patjetër që vij me lëvizjen paralele.

Por mund të jenë më tepër sesa ato që propozoni ju.

Naureda Llagami: Të mbajmë standardet deri në fund, se nuk mund të ndryshojmë standardet pas një muaji.

Marçela Shehu: Unë parimisht jam dakord me propozimin, vetëm se sikurse e thashë, kam nevojë për një paraqitje të saktë të të gjitha të dhënave lidhur me strukturën e

të gjitha gjykatave, pse jo edhe një informacion me ecurinë e procesit të vlerësimit për gjyqtarët që mund të rezultojnë jashtë strukture. Për shembull znj. {...} është në procedura lëvizjeje paralele apo ngritje në detyrë (nuk jam shumë e saktë); edhe zonja Rudina Palloj edhe zonja {...} janë në procedurë ngritjeje në detyrë; për të parë pastaj dhe për të vlerësuar. Në qoftë se procedura e ngritjes në detyrë është në fund, çfarë kuptimi ka që ne të bëjmë sistemime.

Gjithsesi thashë, parimisht jam dakord. Më duhet ky informacion që të jem gati për mbledhjen tjetër.

Naureda Llagami: Tjetër? Kemi diskutime të tjera?

Për mbledhjen tjetër, si e mendoni? Çfarë informacioni do na sjellë Komisioni i Zhvillimit të Karrierës?

Klodian Kurushi: Referenca ligjore e propozuar nga zonja Ukperaj na bën që ne ta tërheqim njëherë këtë relacionin që kemi sjellë sot dhe të rirregullojmë relacionin tonë, duke e parë edhe në prizmin e gjyqtarëve që mund të jenë jashtë strukturave organike në gjykatat ku ato ushtrojnë funksionin ose do të ushtronin funksionin.

Kështu që në këtë pikë ne duhet të tërheqim relacionin – ky është propozimi im për sot – për ta riparë edhe një herë. Në këtë prizëm.

Naureda Llagami: Dakord pra. E shtymë këtë çështje, për të pritur relacionin tuaj dhe duke marrë në konsideratë qëndrimet që ka mbajtur Këshilli nga janari deri tani lidhur me çështjet e ristrukturimit dhe pjesën e lëvizjes paralele.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 14.06.2023)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.21, datë 18.01.2023, për kandidatit z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:14 dhe mbaroi në orën 15:30.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Irena Plaku*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

10. Brikena Ukperaj (anëtare)

11. Yllka Rupa (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Luan Dibra, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani dhe Vjollca Kola Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.

5. Mary Kate Butterfield dhe Blerina Fani, përfaqësues të OPDAT-it.

6. Valbona Bala, eksperte (EWMI-INL).

7. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.21, datë 18.01.2023, për kandidatit z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Naureda Llagami: Kalojmë në çështjen tjetër të rendit të ditës, që ka të bëjë me përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për z. {...}. Relator është z. Toro.

Alban Toro: Faleminderit!

Më herët nga ana e Këshillit ka filluar procedura e lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Durrës dhe për këtë qëllim janë hapur disa pozicione vakante në këto gjykata, me vendimet nr. 11 – nr. 24, 18.01.2023. Një nga kandidatët për pozicionet e lira nr. 17 dhe nr. 21, 18.01.2023, ka kandiduar dhe zoti {...}, aktualisht gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Juridiksioni i Përgjithshëm Korçë, për të cilin

janë kryer disa veprime procedurale në kuadër të verifikimit të kushteve dhe kriterëve formale për këtë kandidim si dhe vlerësimet etiko-profesionale.

Me vendimin nr. 115, 13.03.2023 ka filluar procedura e verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Durrës, të shpallura me vendimet përkatëse.

Me vendimin nr. 273, datë 25.05.2023 është vendosur kualifikimi i z. {...} dhe vijimi i procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës civile, të shpallur me vendimet nr. 17 dhe nr. 21, datë 18.01.2023.

Ndërkohë, në datën 05.06.2023, zoti {...} ka paraqitur kërkesë për tërheqje nga kandidimi për procedurën e lëvizjes paralele për pozicionin e lirë me nr. 21, datë 18.01.2023, në fushën e së drejtës civile, Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, protokolluar kjo me aktin nr. 3206, datë 05.06.2023, duke parashtruar ndër të tjera: “Në mbështetje të vendimit nr. 320 datë 17.09.2020po ju paraqes kërkesën për heqje dore nga kandidimi për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 21, datë 18.01.2023 të KLGJ-së”.

Pra siç rezulton edhe në vetë citimin që ka bërë gjyqtari, procedura e tërheqjes së gjyqtarit gjatë kandidimit të tij është e parashikuar në aktin tonë normativ, të përfaqësuar nga vendimi i Këshillit 320, datë 17.09.2020. Në këtë kuadër është përgatitur projektvendimi në dispozitivin e të cilit ju sugjerohet të miratoni:

1. Përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 21, datë 18.01.2023, për kandidatin z. {...}, për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi për këtë pozicion.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, kalojmë në votimin e projekt-aktit, nëse nuk keni diskutime.

Illir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (*lapsus gjykata, duhet Durrës*), për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 21, datë 18.01.2023, për kandidatin z. {...}, për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi për këtë pozicion.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor [...].

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 14.06.2023)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për mbarimin e statusit të magjistratit për z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:14 dhe mbaroi në orën 15:30.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Irena Plaku*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
10. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Luan Dibra, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani dhe Vjollca Kola Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
- 5. Mary Kate Butterfield dhe Blerina Fani, përfaqësues të OPDAT-it.*
- 6. Valbona Bala, eksperte (EWMI-INL).*
- 7. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për mbarimin e statusit të magjistratit për z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti tjetër i cili ka të bëjë me mbarimin e statusit të magjistratit për z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës. Për më shumë detaje fjalën ia jap z. Klodian Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit zonja Kryetare!

Pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, është depozituar kërkesa datë 22.02.2023 nga gjyqtari z. {...}, i cili është aktualisht gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, nëpërmjet të cilës ka vënë në dijeni, mbarimin e statusit të magjistratit, si shkak i mbushjes së moshës për pension pleqërie.

Zoti {...} ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës më datë 24.08.1985 dhe ka përfunduar studimet “Master i Nivelit të Dytë” pranë Universitetit të Tiranës në vitin 2010.

Referuar të dhënave të librezës së punës rezulton se z. {...} është emëruar gjyqtar

në Gjykatën e Rrethit Vlorë më datë 01.08.1987.

Me vendimin nr. {...}, datë 03.06.1992 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë transferohet si gjyqtar ushtarak pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Me vendimin nr. {...}, datë 22.06.1992 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë caktohet në pozicion si Zv/Kryetar pranë Gjykatës së Apelit Vlorë.

Me vendimin nr. {...}, datë 23.02.1993 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë lirohet nga detyra me kërkesën e tij.

Me dekretin nr. {...}, datë 05.04.2010 të Presidentit të Republikës emërohet gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, dhe nga data 01.05.2023 ka ushtruar funksionin e gjyqtarit pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës. Pra nga data 01.05.2023, me ndryshimin e funksionalitetit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, ai aktualisht ushtron funksionin pranë kësaj gjykate.

Nga data 12.05.2023 shkarkohet nga detyra me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (duke u pezulluar dhe paguhet me 75% të pagës deri në vendimmarrje nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit).

Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit në profilin gjyqtar është 18 vite.

Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 64 të tij, parashikon kohëzgjatjen në detyrë të magjistratit. Një ndër rastet e mbarimit të statusit të magjistratit është edhe kur ai mbush moshën për pension. Konkretisht neni 64, pika 1 citojmë si më poshtë:

1. “Statusi i magjistratit mbaron në rastet kur: a) jep dorëheqjen; b) vërtetohen kushtet e pazgjedhshmërisë dhe të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit; c) mbush moshën e pensionit të pleqërisë, sipas parashikimit të këtij ligji; ç) shkarkohet nga funksioni për përgjegjësi disiplinore, sipas parashikimeve të këtij ligji; d) vërtetohet fakti i pamundësisë për të ushtruar detyrën. ...”

Ndërsa në pikën 5 të po këtij neni, parashikohet se:

“Magjistrati del në pension pleqërie në moshën 67 vjeç. Magjistrati, me kërkesën e tij, mund të qëndrojë në detyrë deri në moshën 70 vjeç. Kërkesa për qëndrimin në detyrë paraqitet jo më vonë se 6 muaj përpara plotësimit të moshës për pension. Statusi i magjistratit mbaron kur mbush moshën 67 vjeç ose moshën 70 vjeç, në rastet kur ka

kërkuar të qëndrojë në detyrë deri në këtë moshë. Këshilli deklaron me vendim mbarimin e statusit të magjistratit, jo më vonë se dy javë para fundit të muajit përkatës.

Komisioni i pavarur i kualifikimit në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar është shprehur për statusin e z. {...}. KPK me vendimin përkatës së saj, duke e shkarkuar nga detyra dhe ai praktikisht është i pezulluar dhe trajtohet me 75% të pagës së gjyqtarit.

Vlerësimi i Komisionit

Kjo dispozitë ligjore ngarkon Këshillin e Lartë Gjyqësor me përgjegjësinë për deklarimin me vendim, të mbarimit të statusit të magjistratit në rastin e plotësimit të kushteve të parashikuara në ligj për të dalë në pension.

Nga dokumentet e vëna në dispozicion nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, rezulton se z. {...} është i datëlindjes 1956. Për rrjedhojë ai mbush moshën për pension pleqërie 67 vjeç. Në këto rrethana, kur kërkesa për mbarimin e statusit plotëson kushtet e pikës 1 dhe 5 të nenit 64 të Ligjit për Statusin, është vendi që Këshilli i Lartë Gjyqësor të deklarojë mbarimin e statusit të magjistratit për kërkuesin, për shkak të mbushjes së moshës së pensionit të pleqërisë. Ligji garanton qëndrimin në detyrën e magjistratit deri në mbushjen e moshës 67 vjeç. Zoti {...} në kërkesën e tij ka parashtruar se: “Kërkoj daljen në pension më datë 13 qershor 2023, në kohën e mbushjes së moshës 67 vjeç”, duke shtuar gjithashtu se: “...lidhur me këtë kërkesë, vlerësoj se duhet të njoftohet edhe Komisioni i Pavarur i Kualifikimit Tiranë, lidhur me procesin e vetting-ut...”

Lidhur me efektet juridike, bazuar në pikën 5, të nenit 64, të Ligjit për Statusin, Këshilli deklaron me vendimin mbarimin e statusit jo më vonë se dy javë para fundit të muajit përkatës.

Në këtë rast, mosha për pension pleqërie arrihet më datë 13.06.2023, e për rrjedhojë efektet e këtij vendimi parashikohen në datën 30.06.2023.

Struktura e projektvendimit

Projektvendimi është i strukturuar në 4 pika.

Në pikën e parë parashikohet deklarimi i mbarimit të statusit të magjistratit për z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për shkak të mbushjes së moshës së pensionit të pleqërisë.

Në pikën e dytë parashikohen efektet juridike. Efektet e këtij vendimi fillojnë më datë 30.06.2023.

Në pikën e tretë parashikohet komunikimi i këtij vendimi. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtarit z. {...} sipas kërkesave të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Në pikën vijuese parashikohet e drejta e ankimit kundër këtij vendimi, i cili mund të bëhet brenda 15 ditëve nga data e njoftimit në Gjykatën Administrative të Apelit.

Së fundmi parashikohet dhe hyrja në fuqi dhe publikimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, kalojmë në votim.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për shkak të mbushjes së moshës së pensionit të pleqërisë.

2. Efektet e këtij vendimi fillojnë më datë 30.06.2023.

3. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtarit {...} sipas kërkesave të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të

drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 14.06.2023)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimi “Për mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013–2016, për gjyqtaren {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Brikena Ukperaj).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:14 dhe mbaroi në orën 15:30.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Irena Plaku*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

10. Brikena Ukperaj (anëtare)

11. Yllka Rupa (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Luan Dibra, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani dhe Vjollca Kola Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.

5. Mary Kate Butterfield dhe Blerina Fani, përfaqësues të OPDAT-it.

6. Valbona Bala, eksperte (EWMI-INL).

7. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

RENDI I DITËS:

5. Shqyrtimi i projektvendimi “Për mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013–2016, për gjyqtaren {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Brikena Ukperaj).

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti i radhës që ka të bëjë me mosfillimin e procedurës për vlerësimin etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013–2016, për gjyqtaren {...}. Për më shumë detaje, znj. Ukperaj!

Brikena Ukperaj: Faleminderit zonja Kryetare!

Këshilli i Lartë Gjyqësor, ka vendosur fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional, me qëllim gradimin e të gjithë gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar dhe për të cilët kanë ardhur në Këshill dosjet me aktet e vlerësimit profesional nga organet e rivlerësimit kalimtar. Një nga këta gjyqtarë është edhe znj. {...}, e cila është gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm

Vlorë, aktualisht e komanduar në Njësinë e Vlerësimit Etik dhe Profesional në KLGJ.

Me vendimin nr.643, datë 11.04.2023, KPK-ja ka vendosur:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit {...}, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit [...] etj.

Ky vendim ka marrë formë të prerë pasi nuk rezulton që ndaj këtij vendimi të jetë bërë ankim.

Para se Komisioni të vlerësonte nëse ishim në kushtet e fillimit të procedurës së gradimit apo jo, bëri një shqyrtim paraprak dokumentacionit të dosjes të përcjellë nga organet e rivlerësimit sipas edhe praktikës që kemi ndjekur pas orientimeve të Gjykatës së Apelit Administrativ, nga na rezultoi se zonja {...} në periudhën tetor 2012 – shtator 2015 ka ndjekur studimet në Shkollën e Magjistraturës. Gjatë kësaj periudhe, nga tetori 2014 deri në muajin gusht 2015 ka zhvilluar stazhin profesional pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe është emëruar gjyqtare me dekretin e Presidentit të Republikës nr. {...}, datë 23.06.2016.

Sa më sipër, rezulton se gjatë periudhës së vlerësimit tetor 2013 – tetor 2016, znj. {...} ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në dy periudha:

(i) Praktikën profesionale të vitit të tretë të Shkollës së Magjistraturës nga muaji tetor 2014 deri në muajin gusht 2015, për një kohëzgjatje prej 11 muajsh;

(ii) Funkcionin e gjyqtarit për periudhën 23.06.2016 deri në datë 13.10.2016, për një kohëzgjatje prej 3 muaj e 20 ditë.

Nuk po i lexoj dispozitat e tjera të ligjit, janë të parashikuara në relacion.

Duke marrë parasysh parashikimet e ligjit për Shkollën e Magjistraturës dhe të rregullores përkatëse. Ne kemi mbajtur edhe herë tjetër qëndrimin që periudha e stazhit profesional nuk përbën vit pune përvojë për efekt të gradimit. Nga ana tjetër na rezulton se zonja {...} nuk ka më shumë se 1 vit punë si gjyqtare pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës dhe në këto kushte kemi vlerësuar (duke mbajtur edhe standardin e mbajtur ndaj gjyqtarëve të tjerë, që kanë mbaruar në të njëjtin vit Shkollën e Magjistraturës me zonjën {...}) që në këtë rast fillimi i procedurës së vlerësimit nuk mund të kryhet pasi koha e ushtrimit të detyrës së saj brenda periudhës së vlerësimit është më e shkurtër se 1 vit.

Është hartuar edhe projektvendimi përkatës, në pikën e parë të të cilit do të gjeni mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarës {...}, për periudhën e vlerësimit 2013–2016, për shkak se koha e ushtrimit të detyrës, brenda periudhës së vlerësimit, është më e shkurtër se një vit.

Pika e dytë përmban mënyrën e njoftimit të vendimit, dhe pika e tretë të drejtën e ankimit ndaj këtij vendimi, që përbën akt administrativ individual.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Nëse s’kemi diskutime...

Atëherë, kalojmë në votimin e projekt–aktit.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) e gjyqtarës {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016, për shkak se koha e ushtrimit të detyrës, brenda periudhës së vlerësimit, është më e shkurtër se një vit.

2. Një kopje e vendimit t’i njoftohet znj.{...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të

arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimitetit.

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 14.06.2023)

Pika 6 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi):

- 6.1 Për komandimin e z. {...} si ndihmësmagjistrat në Gjykatën e Lartë;
- 6.2 Për komandimin e znj. {...} si ndihmësmagjistrate në Gjykatën e Lartë;
- 6.3 Për komandimin e znj. {...} si ndihmësmagjistrate në Gjykatën e Lartë;
- 6.4 Për komandimin e znj. {...} si ndihmësmagjistrate në Gjykatën e Lartë;
- 6.5 Për komandimin e znj. {...} si ndihmësmagjistrate në Gjykatën e Lartë.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:14 dhe mbaroi në orën 15:30.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Illir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Irena Plaku*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ridvan Hado*** (anëtar)

8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Marçela Shehu* (anëtare)
10. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
11. *Yllka Rupa* (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerita Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani dhe Vjollca Kola Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
5. *Mary Kate Butterfield dhe Blerina Fani, përfaqësues të OPDAT-it.*
6. *Valbona Bala, eksperte (EWMI-INL).*
7. *Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*

RENDI I DITËS:

6. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi):

- 6.1 Për komandimin e z. {...} si ndihmësmagjistrat në Gjykatën e Lartë;
- 6.2 Për komandimin e znj. {...} si ndihmësmagjistrate në Gjykatën e Lartë;
- 6.3 Për komandimin e znj. {...} si ndihmësmagjistrate në Gjykatën e Lartë;
- 6.4 Për komandimin e znj. {...} si ndihmësmagjistrate në Gjykatën e Lartë;
- 6.5 Për komandimin e znj. {...} si ndihmësmagjistrate në Gjykatën e Lartë.

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktin e radhës që ka të bëjë me komandimet për pesë magjistratë në pozicionin e ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë. Për më shumë detaje fjalën ia jap zotit Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit!

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 79, shkronja “b”, dhe 86, shkronja

“d”, të Ligjit nr.115/2016, në nenet 8, 53, 54, 56, 57 dhe 58 të Ligjit nr.96/2016, si dhe ligjin nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, me vendimin nr. 156, datë 29.03.2023 ka vendosur:

“1. Hapjen e procedurës së komandimit të gjyqtarit në pozicionin e ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë. 2. Shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Gjykatën e Lartë për 5 (pesë) pozicione “ndihmësmagjistrat” në Njësinë e Shërbimit Ligjor në Gjykatën e Lartë.”.

2. Afati i paraqitjes së kërkesave për komandim është data 13 prill.

3. Brenda afatit të caktuar për paraqitjen e kërkesave për komandim, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor janë paraqitur gjithsej fillimisht 7 (shtatë) kërkesa. Më pas me shkresën nr. 2380/1, datë 19.04.2023 gjyqtarja {...} ka deklaruar se është tërhequr nga kandidimi për pozicionin “ndihmësmagjistrat” në Gjykatën e Lartë.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në bazë të opinionit të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, me vendimin nr. 229, datë 11.05.2023 ka vendosur: “T’i dërgohen Gjykatës së Lartë emrat e z. {...}, z. {...}. znj. {...}, znj. {...}, znj. {...} dhe znj. {...}, të cilët kanë aplikuar për t’u komanduar, në pozicionin “ndihmësmagjistrat” në Gjykatën e Lartë, si dhe praktikat dokumentare të paraqitura prej tyre në lidhje me kriteret preferenciale të komandimit, si dhe të dhënat mbi përvojën profesionale të tyre”.

Opinionit është hartuar për 6 (gjashtë) kandidatët si më sipër, pasi një prej kandidatëve, siç e përmenda më lart u tërhoq nga kandidimi.

Me shkresën nr. {...} prot., datë 31.05.2023, bazuar në nenin 54, pika 5, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve”, Gjykata e Lartë i ka kërkuar Këshillit komandimin e gjyqtarëve: z. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...} dhe znj. {...} në pozicionin “ndihmësmagjistrat” në Njësinë Ligjore për një periudhë 5-vjeçare.

Në respektim të përcaktimit të bërë në pikën 5, të nenit 54, të Ligjit nr. 96/2016, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka detyrimin të shqyrtojë kërkesën e paraqitur nga Gjykata e Lartë brenda dy javëve nga marrja e saj, duke përcaktuar nëse është rasti dhe kushtet e komandimit.

Vlerësimi i Komisionit.

Lidhur me afatin e komandimit. Neni 54, pika 1, i Ligjit nr. 96/2016 ka

parashikuar një afat maksimal të komandimit deri në pesë vjet, afat të cilin edhe Gjykata e Lartë ka kërkuar në rastin konkret. Duke mbajtur në konsideratë se si rezultat i zbatimit të Ligjit 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” apo të procesit të ngritjes në detyrë të gjyqtarëve në gjykata, në të ardhmen mund të ndodhemi në situatën e cenimit të funksionalitetit normal të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksioni të Përgjithshëm Elbasan, Lezhë, Fier, Berat, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës vlerëson që në kuptim të nenit 57, pika 1, të Ligjit nr. 96/2016 në vendimin e komandimit të parashikohet edhe mundësia e ndërprerjes së komandimit përpara afatit kur një gjë e tillë do të jetë e domosdoshme për interesat më të lartë të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksioni të Përgjithshëm Elbasan, Lezhë, Fier, Berat.

Sa i përket datës së fillimit të afatit të komandimit, Komisioni ka marrë të dhënat përkatëse për ngarkesën respektive të çdo gjyqtari nga ku nga Gjykata e Lartë është kërkuar/bërë propozimi i tyre. Të dhënat janë të inkorporuara në këtë relacion: për zotin z. {...} ai ka në total gjithsej 974 çështje; znj. {...} – 239; znj. {...} – 292; zonja {...} – 262 dhe znj. {...} ka gjithsej 226 çështje.

Sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor:

1. Të komandojë gjyqtarin z. {...}/znj. {...}/znj. {...}/znj. {...}/znj. {...} në pozicionin e “Ndihmësmagjistratit” në Njësinë e Shërbimit Ligjor të Gjykatës së Lartë, për një afat deri në 5 (pesë) vjet.

2. Të përcaktojë fillimin e afatit të komandimit më datë 15 korrik 2023 (në varësi edhe të shqyrtimit të këtij projekt–akti nga Këshilli).

3. Të përcaktojë që afati i komandimit mund të ndërpritet nëse Këshilli i Lartë Gjyqësor do të konstatojë cenim të funksionalitetit normal të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksioni të Përgjithshëm Elbasan/Lezhë/Fier/Berat.

4. Të urdhërojë përjashtimin e menjëhershëm të gjyqtarit z. {...}/znj. {...}/znj. {...}/znj. {...}/znj. {...} nga procedurat e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksioni të Përgjithshëm Elbasan/Lezhë/Fier dhe Berat.

Bashkëlidhur relacionit janë projektvendimet nominativë për çdo kandidat. *(ripërsëritet fjalia.)*

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, ta lëmë me variantin e 15 korrikut, siç e ka sjellë Komisioni? Keni diskutime për afatin?

(Nuk ka diskutime.)

Atëherë, meqë nuk kemi diskutime, kalojmë në votim sipas propozimit të sjellë nga Komisioni, ku afati i kandidimit për të pesë kandidatët që komandohen në Gjykatën e Lartë në pozicionin e “ndihmësmagjistratit”, do të fillojë më datë 15.07.2023.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

- Komandimin e z. {...} si ndihmësmagjistrat në Gjykatën e Lartë;
- Komandimin e zonjës {...} si ndihmësmagjistrat në Gjykatën e Lartë;
- Komandimin e zonjës {...} si ndihmësmagjistrat në Gjykatën e Lartë;
- Komandimin e znj. {...} si ndihmësmagjistrat në Gjykatën e Lartë;
- Komandimin e znj, {...} si ndihmësmagjistrat në Gjykatën e Lartë. Afati i komandimit është 5 vjet dhe fillon më datë 15.07.2023.

* * *

(Pika 6 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 14.06.2023)

Pika 7 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtim i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Irena Plaku):

7.1 Për fillimin e procedurës së përsheptuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional, periudha e vlerësimit viti kalendarik 2022, për gjyqtarët {...}, {...}, {...}, {...}, {...} dhe {...};

7.2 Për fillimin e procedurës së përsheptuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional, periudha e vlerësimit viti kalendarik 2019, për gjyqtarët {...} dhe {...};

7.3 Për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional, të gjyqtares së komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, znj. {...}, për periudhën e vlerësimit 10.02.2020 – 21.11.2022.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:14 dhe mbaroi në orën 15:30.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
- 3. Klodian Kurushi*** (anëtar)

- | | |
|----------------------------|------------------|
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Irena Plaku | (anëtare) |
| 6. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 7. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 8. Alban Toro | (anëtar) |
| 9. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 10. Brikena Ukperaj | (anëtare) |
| 11. Yllka Rupa | (anëtare) |

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Luan Dibra, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani dhe Vjollca Kola Këshilltarë pranë Komisioneve të Përherhshme në Këshill.**
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.**
- 5. Mary Kate Butterfield dhe Blerina Fani, përfaqësues të OPDAT-it.**
- 6. Valbona Bala, eksperte (EWMI-INL).**
- 7. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**

RENDI I DITËS:

7. Shqyrtim i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Irena Plaku):

7.1 Për fillimin e procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional, periudha e vlerësimit viti kalendarik 2022, për gjyqtarët {...}, {...}, {...}, {...}, {...} dhe {...};

7.2 Për fillimin e procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional, periudha e vlerësimit viti kalendarik 2019, për gjyqtarët {...} dhe {...};

7.3 Për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional, të gjyqtarës së komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, znj. {...}, për periudhën e vlerësimit 10.02.2020 – 21.11.2022.

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt–aktin e radhës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimeve për fillimin e procedurave të vlerësimit etik dhe profesional. Projekt–akte të cilat do relatohen nga zonja Irena Plaku dhe ndërkohë ftoj administratën të bëjë gati procedurën e shortit.

Irena Plaku: Faleminderit!

Po paraqes në mënyrë të përmbledhur relacionin për fillimin e procedurës së vlerësimit të përshpejtuar të detyruar për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarëve që kanë plotësuar kriteret ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, të shpallura me vendimet nr. 499, 500, 501, 502, 503 dhe 504, datë 21.11.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Relacioni është një i vetëm, për propozimin për tre projektvendime, pasi projektvendimet duke qenë se për vlerësimin e disa gjyqtarëve ka periudha të ndryshme vlerësimi, janë propozuar tre projektvendime më vete.

Fillimisht Këshilli, pasi ka verifikuar tre dhe katër kriteret ligjore të gjyqtarëve që kanë kandiduar për ngritje në detyrë në pozicionet e shpallura më sipër, janë bërë verifikimi për 24 (njëzet e katër) gjyqtarë me vendimet përkatëse të Këshillit (secili vendim është relatuar në relacionin përkatës).

Ndërsa me vendimin nr.66, datë 09.02.2023, Këshilli ka vendosur që për dy kandidatët znj. {...} dhe z. {...}, nuk është e nevojshme kryerja e verifikimeve për shkak se këto të fundit kishin kandiduar më parë në një pozicion në Gjykatën e Lartë, dhe janë marrë të mirëqenë këto verifikimet.

Referuar ligjit “Për statusin” vlerësimi është i detyruar në rast se për gjyqtarët nuk ka dy vlerësime të mëparshme të realizuara dhe për të cilën nuk është në planin e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Për tre gjyqtarë, znj {...}, znj. {...} dhe znj. {...} është vlerësuar se nuk është e nevojshme nga ana e Komisionit kryerja e një vlerësimi tjetër të përshpejtuar për sa kohë që këto tre gjyqtarë me vendim të KLGJ-së (relatuar në Këshill), janë vlerësuar për një periudhë të zakonshme (periudhën e gradimit) si dhe për periudhën e vlerësimit të përshpejtuar për vitin 2019.

Për gjyqtaret {...}, {...} ka përfunduar vlerësimi etik dhe profesional për dy periudha vlerësimi.

Për gjyqtarin {...} i cili ka kandiduar për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, ka filluar procedura e vlerësimit të përshpejtuar.

Për gjyqtarin {...} është vlerësuar se nuk është e mundur kryerja e një vlerësimi të përshpejtuar, pasur parasysh edhe vendimin e Këshillit për përcaktimin e mundësive të kryerjes së vlerësimit të përshpejtuar (vendimi për lëvizje paralele) dhe është vlerësuar se nuk është e mundur vlerësimi i tij.

Gjithashtu, rezulton se për gjyqtarët të cilët kanë kandiduar, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin përkatës me nr. 177, datë 29.04.2021 dhe me nr.371, datë 13.09.2022 ka filluar procedurën e vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit 2017–2019. Për disa ka filluar dhe për disa ka përfunduar procedura e vlerësimit për periudhën e gradimit (vlerësimi i parë) dhe për disa është në proces, apo do të fillojë pasi të kalojnë me sukses procesin e vlerësimit kalimtar dhe të vihet në dispozicion dosja nga organet e rivlerësimit.

Për gjyqtarët, {...}, {...}, {...} dhe {...}, Këshilli, përkatësisht me vendimet përkatëse, ka vendosur përfundimin pa vendimi ose mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim gradimin, për periudhën e vlerësimit 2013–2016, në kushtet kur këto të fundit nuk kanë pasur statusin e gjyqtarit për këtë periudhë. Si vlerësim i parë për ta për efekt të ngritjes në detyrë do të konsiderohet 2017–2019 dhe për këta gjyqtarë është menduar që të fillojë vlerësimi i fundit kalendarik që përkon me vitin 2022.

Për gjyqtarin {...} i cili ka kandiduar më parë për lëvizje paralele për dy pozicione të lira, ka filluar procedura e vlerësimit të përshpejtuar për vitin 2022. Megjithëse ka pasur ndryshime nga momenti në relacion (*nga momenti që është përpiluar relacioni*) për sa kohë kanë hequr dorë disa gjyqtarë nga lëvizja paralele.

Për gjyqtaren {...} e cila gjithashtu ka kandiduar për ngritje në detyrë, megjithëse ende nuk kemi një vendim të formës së prerë për kalimin e procesit të vetting-ut, edhe për këtë gjyqtare vlerësohet se nuk është e mundur kryerja e vlerësimit për periudhën e gradimit, për shkak se kjo e fundit, ashtu si edhe gjyqtarët e tjerë që i përkasin të njëjtit vit dekretimi, nuk kanë qenë emëruar pas përfundimit të periudhës trevjeçare të Shkollës

së Magjistraturës.

Siç e thamë më sipër, duke qenë se për këta gjyqtarë ka periudha të ndryshme vlerësimi, janë propozuar tre projektvendime.

Në projektvendimin e parë është propozuar “Fillimi i procedurës së vlerësimit të përshpejtuar të detyruar për vitin 2022 për gjyqtarët {...}, {...}, {...}, {...}, {...} dhe {...}”.

Për gjyqtarët {...} dhe {...} të cilët janë konfirmuar me vendim të Komisionit të Posaçëm të Apelimit, konkretisht me vendimin nr. 34/2022 dhe nr. 42/2022, pas ardhjes së dosjes së rivlerësimit, ka filluar procedura e vlerësimit për periudhën e gradimit. Këta të fundit nuk kanë punuar nga momenti i shkarkimit me vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit deri në konfirmimin e tyre në detyrë me vendim të KPA-së sepse të dy janë shkarkuar në vitin 2020. Kështu, periudha e tyre efektive në punë para momentit të kandidimit është vitit 2019, për këtë arsye është propozuar që për këta dy gjyqtarë të fillojë periudha e vlerësimit e përshpejtuar e detyruar për vitin 2019.

Ndërsa për gjyqtaren {...} e cila ka qenë e komanduar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor është propozuar kryerja e periudhës së vlerësimit për një periudhë tjetër, referuar rregullave të reja të miratuara me vendimin nr. 159, datë 05.03.2023 të KLGJ-së për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarëve të komanduar në KLGJ, ku periudha e vlerësimit të saj do të fillojë nga dita e komandimit që i përkon datës 10.02.2020 deri në momentin që kjo e fundit ka kandiduar për ngritje në detyrë, që përkon data 21.11.2022.

Për sa më sipër, Komisioni vlerëson që të propozojë fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional për 9 gjyqtarë (për 8 do fillojë procedura e vlerësimit etik dhe profesional të detyruar – 2 për vitin 2019 dhe 6 për vitin 2022).

Në pikën e parë të projektvendimit do të përcaktohet periudha e vlerësimit etik dhe profesional për secilin gjyqtar; si dhe hedhja në short dhe përcaktimi i relatorit.

Për sa i përket procedurës së përzgjedhjes me short, është vlerësuar që të përfshihen të tre anëtarët e Komisionit, përkatësisht me 3 vlerësime secili (duke qenë se janë 9 vlerësime). Ndërsa në lidhje me nëpunësit është propozuar që 2 vlerësime të marrë znj. Esmerilda Habili, 2 vlerësime Gilda Hoxha dhe 4 vlerësime znj. Erlanda Agaj. Këto do të përfshihen në tetë procedura, duke qenë se për {...} referuar rregullave të miratuara nuk është e nevojshme caktimi i nëpunëses përgjegjëse

Kaq ishte në mënyrë të përmbledhur.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, administrata të fillojë me procesin e hedhjes së shorteve.

Nga njëra anë do të hidhen në gogla emrat e tre relatorëve...

Procedura e shortit si vijon:

Në enën e parë hidhen shiritat e letrës me emrat e gjyqtarëve: z. {...}, z. {...}, z. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, z. {...}, z. {...}, znj. {...}.

Në enën e dytë hidhen shiritat e letrës me emrat e relatorëve: znj. Brikena Ukperaj (3 shirita letre), znj. Irena Plaku (3 shirita letre), znj. Yllka Rupa (3 shirita letre).

Në enën e tretë hidhen shiritat e letrës me emrat e nëpunësve përgjegjës: znj. Esmerilda Habili (2 shirita letre), znj. Gilda Hoxha (2 shirita letre), znj. Erlanda Agaj (4 shirita letre).

Procedura e përzgjedhjes si vijon:

Përzgjidhet shiriti me emrin e z. {...}. Relator për z. {...} përzgjidhet znj. Irena Plaku. Nëpunës përgjegjës për vlerësimin përzgjidhet znj. Gilda Hoxha.

Përzgjidhet shiriti me emrin e z. {...}. Relator për z. {...} përzgjidhet znj. Brikena Ukperaj. Nëpunës përgjegjës për vlerësimin përzgjidhet znj. Erlanda Agaj.

Përzgjidhet shiriti me emrin e z. {...}. Relator për z. {...} përzgjidhet znj. Irena Plaku. Nëpunës përgjegjës për vlerësimin përzgjidhet znj. Erlanda Agaj.

Përzgjidhet shiriti me emrin e znj. {...}. Relator për znj. {...} përzgjidhet znj. Yllka Rupa. Nëpunës përgjegjës për vlerësimin përzgjidhet znj. Esmerilda Habili.

Përzgjidhet shiriti me emrin e z. {...}. Relator për z. {...} përzgjidhet znj. Brikena Ukperaj. Nëpunës përgjegjës për vlerësimin përzgjidhet znj. Erlanda Agaj.

Përzgjidhet shiriti me emrin e znj. {...}. Relator për znj. {...} përzgjidhet znj. Yllka Rupa. Nëpunës përgjegjës për vlerësimin përzgjidhet znj. Erlanda Agaj.

Përzgjidhet shiriti me emrin e z. {...}. Relator për z. {...} përzgjidhet znj. Yllka Rupa. Nëpunës përgjegjës për vlerësimin përzgjidhet znj. Esmerilda Habili.

Përzgjidhet shiriti me emrin e znj. {...}. Relator për znj. Osmani përzgjidhet znj. Irena Plaku.

Përzgjidhet shiriti me emrin e znj. {...}. Relator për znj. {...} përzgjidhet znj.

Brikena Ukperaj. Nëpunës përgjegjës për vlerësimin përzgjidhet znj. Gilda Hoxha.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Kalojmë në votim?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Dakord.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Fillimin e procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional periudha e vlerësimit viti kalendarik 2022, për gjyqtarët z. {...}, z. {...}, z. {...}, znj. {...}, znj. {...} dhe znj. {...}.

2. Caktimin e relatorit dhe nëpunësit përgjegjës për vlerësimin për secilin gjyqtar, si më poshtë:

Për gjyqtarin z. {...} – Relator znj. Irena Plaku – Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Gilda Hoxha.

Për gjyqtarin z. {...} – Relator znj. Brikena Ukperaj – Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Erlanda Agaj.

Për gjyqtarin z. {...} – Relator znj. Irena Plaku – Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Erlanda Agaj.

Për gjyqtaren znj. {...} – Relator znj. Yllka Rupa – Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Esmerilda Habili.

Për gjyqtaren znj. {...} – Relator znj. Yllka Rupa – Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Erlanda Agaj.

Për gjyqtaren znj. {...} – Relator znj. Brikena Ukperaj – Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Gilda Hoxha.

Projektvendimi i dytë:

Për gjyqtarin z. {...} – Relator znj. Yllka Rupa – Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Esmerilda Habili.

Për gjyqtarin z. {...} – Relator znj. Brikena Ukperaj – Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Erlanda Agaj.

Projektvendimi i tretë:

2. Caktimin e znj. Irena Plaku si relatore për vlerësimin e gjyqtares së komanduar, znj. {...}.

* * *

(Pika 7 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 14.06.2023)

Pika 8 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim dhe shtesë në vendimin nr. 271, datë 25.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë të riorganizuar”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:14 dhe mbaroi në orën 15:30.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Irena Plaku*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
10. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Luan Dibra, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani dhe Vjollca Kola Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
- 5. Mary Kate Butterfield dhe Blerina Fani, përfaqësues të OPDAT-it.*
- 6. Valbona Bala, eksperte (EWMI-INL).*
- 7. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*

RENDI I DITËS:

8. Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim dhe shtesë në vendimin nr. 271, datë 25.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë të riorganizuar”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt–akti tjetër.

Në fakt, projekt–akti tjetër është një gabim (lapsus) që është bërë gjatë zbardhjes së vendimit për fillimin e funksionimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë të riorganizuar.

Gjatë procesit që kemi miratuar aktet dhe ne i kemi reflektuar ndryshimet, procedura e zbardhjes nga ana e drejtorisë nuk është bërë ashtu sikurse ne e kemi relatuar. Por kjo gjë është reflektuar në Fletoren Zyrtare dhe për ta ndryshuar atë gjë në Fletoren Zyrtare, duhet që të merrnim një vendim (pra nuk pranohet pa një lloj vendimmarrjeje nga ana e Këshillit). Për këtë arsye kemi sjellë thjesht për ndreqje gabimi vendosjen e togfjalëshit “brenda muajit korrik 2023”. Tek Gjykata e Lushnjës e kishim vendosur (tek riorganizimi). Tek riorganizimi i Tiranës, në Këshill e kemi votuar dhe e kemi diskutuar,

por në zbardhje nuk është reflektuar. Kjo është arsyeja dhe qëllimi i këtij projekt–akti.

Nëse jemi dakord, kalojmë në votim.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Dakord.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Atëherë, me kaq ne kemi përfunduar çështjet që i kemi “online”.

Naureda Llagami: Përpara se ta mbyll kam vetëm dy porosi për komisionet respektive.

E para, për Komisionin e Zhvillimit të Karrierës që të hartojë projekt–aktin që e hoqëm sot nga rendi i ditës për ta sjellë; dhe e dyta, për Komisionin e Vlerësimit, që të na japë një informacion të detajuar mbi situatën që kanë vlerësimet aktualisht për ngritjet në detyrë apo lëvizjet paralele, për të lejuar Këshillin që të ketë një pasqyrë më të gjerë për sa i përket punës dhe si do të avancojmë. Unë i kërkoj këto shpejt, sepse i kemi prioritete.

Kështu që javën tjetër, nga të dy Komisionet, me mirëkuptimin e të gjithë grupeve. Ishte kërkesë e zonjës Shehu dhe unë për në fund e lashë për kujtesë, për të dy Komisionet.

Me kaq e mbyllim mbledhjen plenare me regjistrim për të lejuar më pas diskutimin e çështjes së fundit.

* * *

(Pika 8 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

